

2021

RAPORTI VJETOR I

QËNDRUESHMËRISË

SHARRCEM

a  **TITAN** Group Company



RRETH RAPORTIT

Është një nder i madh për ne që t'ju prezantojmë Raportin Vjetor të Qëndrueshmërisë së kompanisë Sharrcem për vitin 2021 pasi ky vit shënon 10 vjetorin e angazhimit dhe praktikës së vazhdueshme të Sharrcemit për raportim vjetor ndaj palëve të interesit. Kjo praktikë, e ngulitur në kulturën tonë, lidhet me ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit. Në këtë drejtim, ky raport paraqet një moment historik të rëndësishëm në rrugëtimin tonë në Kosovë dhe në mbarë botën, duke pasur parasysh se gjatë viteve, Sharrcemi ka kontribuar në ngritjen e dialogut me palët e interesit si dhe në transparencën korporative në vend duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të industrisë.

Qëllimi i një raportimi të tillë nuk është vetëm të demonstrojë vendosmërinë tonë për të qenë dhe për të vepruar si fqinjë të denjë në mesin e kolegëve tanë, si brenda ashtu edhe jashtë kompanisë, duke respektuar kushtet e barazisë dhe paanshmërisë, por edhe të dëgjojmë pritshmëritë e palëve tona të interesit dhe t'i shtojmë vlerë qëndrueshmërisë dhe prosperitetit të komuniteteve me të cilat bashkëveprojmë për të përballuar rreziqet dhe mundësitë e tanishme dhe të ardhshme. Që nga koha e raportimit të parë vjetor në vitin 2012, kompania i ka qëndruar besnike angazhimit të saj për të paraqitur rritjen, zhvillimin, kontributin dhe inovacionin e saj tek të gjitha palët e interesit, duke e bërë këtë në mënyrë transparente dhe me kohë. Këtë vit, derisa festojmë 10-vjetorin e raportimit, kemi arsye të ndihemi krenarë se sa larg kemi arritur së bashku dhe gjithashtu për ndikimin që ka pasur angazhimi ynë.

Raporti Vjetor i Qëndrueshmërisë nga Sharrcem për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm: "Raporti") paraqet një pasqyrë të operacioneve dhe performancës së kompanisë për periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2021. Raporti është një dokument gjithëpërfshirës që përmban informacione të përditësuara dhe relevante në lidhje me proceset, rezultatet, angazhimin dhe performancën e kompanisë, veçanërisht kur ato lidhen me qëndrueshmërinë. Ai gjithashtu mbështet dhe ushqen vizionin strategjik të kompanisë në përputhje me qasjen globale të Grupit të Çimentos TITAN sa i përket monitorimit dhe raportimit.

Duke qenë në përputhje me standardet e cilësisë të zbatuara nga kompania, Raporti është në përputhje me standardet përkatëse globale të raportimit specifik për sektorin. Kjo sigurohet nga Letra e Garancisë e palëve të treta të pavarura dhe Indeksi i Performancës së Qëndrueshmërisë, i cili është i lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara për vitin 2030 (OZhQ-të e OKB-së). Raporti është në përputhje edhe me kriteret e nivelit të avancuar për vlerësim të pavarur dhe në përputhje me Udhëzimet e Kompaktit Global të OKB-së mbi Progresin si dhe me Kartën dhe Udhëzimet e Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA).

Duke qenë në përputhje me qasjen globale të Grupit të Çimentos TITAN, që nga viti 2018, Sharrcemi zbaton Udhëzimet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) të cilat e lidhin raportimin mbi Qëndrueshmërinë me OZhQ-të e OKB-së për vitin 2030 dhe me nën-objektivat tona të ndikimit.

Informacioni rreth performancës së Sharrcemit në vitin 2021 përfshihet gjithashtu në Raportin Vjetor të Integruar të Grupit të Çimentos TITAN për vitin 2021 (IAR 2020) në të cilin mund të qaseni me pajisje mobile duke përdorur këtë kod QR.



Është me rëndësi të theksohet se të gjitha informacionet e shpalosura në këtë raport përpunohen dhe mbështeten nga sistemet e Grupit të cilat janë krijuar për të organizuar dhe kontrolluar të dhënat e performancës në fushën e ESG-së (Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje).

Grant Thornton L.L.C. në Prishtinë ka bërë një raport të Pavarur të Garancisë së Kufizuar lidhur me Raportin Vjetor të Qëndrueshmërisë për vitin 2021, në një nivel të kufizuar për të verifikuar që Raporti plotëson si Kartën ashtu edhe Udhëzimet e Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA) dhe kriteret e nivelit të avancuar të Kompaktit Global të OKB-së mbi Progresin. Ky është viti i katërt radhazi që raporti vjetor i Sharrcemit verifikohet në mënyrë të pavarur sipas standardeve ndërkombëtare (UNGC CoP) dhe standardeve specifike të industrisë (GCCA) në nivelin e avancuar të kërkesave të Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara (UNGC).

Raporti i Pavarur i Garancisë së Kufizuar përfshihet në Raportin Vjetor të Qëndrueshmërisë për vitin 2021 dhe është në dispozicion në uebfaqen tonë: www.sharrcem.com

Raporti përfshin operacionet e Grupit të Çimentos TITAN në Kosovë sipas titullit Sharrcem që përbëhet nga fabrika e çimentos Sharrcem SH.P.K, tri gurore dhe filialet në pronësi të plotë, Esha Material LLC dhe "Kosovo Construction Materials LLC të cilat menaxhojnë терминаlet e Cement Plus në Lipjan, Duhël dhe Klinë.

Raporti është i një rëndësie të veçantë. Ai shërben si një instrument për të orientuar angazhimin e kompanisë në përputhje me vlerat dhe standardet tona, drejt realizimit të vizionit të kompanisë përmes fushave përkatëse të punës.

Sharrcemi i kushton një vlerë të madhe komunikimit të hapur dhe transparent me palët e interesit, partnerët dhe komunitetin. Prandaj, ne mirëpresim çdo koment në lidhje me performancën tonë. Jemi vërtet të interesuar për mendimin tuaj që na ndihmon të përmirësohemi më tej dhe të eksplorojmë fusha të reja pune në mënyrë që të mund të kontribuojmë vazhdimisht në një rritje të përbashkët si biznese dhe shoqëri.



Shënim për përdorimin e logos së UNGC-së 'We Support':

Ne vërtetojmë se kompania jonë amë TITAN Group merr pjesë në Paktin Global të OKB-së dhe ne mbështesim Dhjetë Parimet dhe avancimin e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe Objektivat më të gjera të OKB-së. Ne e konsolidojmë plotësisht mbështetjen tonë për këtë iniciativë në kuadër të angazhimit të kompanisë amë. Prandaj, ne nuk marrim pjesë në aktivitetet e Kompaktit Global të OKB-së dhe nuk marrim pjesë në aktivitetet e Rrjetit Lokal të Kompaktit Global.

TABELA E PËRMBAJTJES


TË DHËNAT PËR VITIN 2021	6
MESAZHI NGA DREJTORI MENAXHUES	7
KUSH ËSHTË GRUPI TITAN	11

KUSH ËSHTË SHARRCEMI

HISTORIKU YNË	19
SHARRCEMI SOT	21
PRODUKTET TONA	23
KLIENTËT TANË	23
SISTEMET E MENAXHIMIT	24
SHPËRNDARJA E VLERËS PËR TË GJITHË	25
VLERËSIMI I MATERIALITETIT	26

RAPORTI I MENAXHMENTIT

STRUKTURA QEVERISËSI, BOARDET, DHE ROLET E TYRE	29
SHQYRTIMI I PERFORMANCËS NË FUSHËN E ESG-së	33
DEKARBONIZIMI DHE DIGJITALIZIMI	33
ZHVILLIMI - MUNDËSI NË PUNË	35
NDIKIMI POZITIV NË MJEDISIN LOKAL	40
BURIME TË PËRGJEGJSHME	49
QEVERISJA E MIRË, TRANSPARENCA DHE ETIKA NË BIZNES	51
PERFORMANCA FINANCIARE	54
DEKLARATAT E PERFORMANCËS NË FUSHËN ESG	55
INDEKSI I RISHIKIMIT TË PROGRESIT PËR 10 PARIMET E UNGC-së	80
RAPORTI I PAVARUR I GARANCISË SË KUFIZUAR	82
FJALORTHË	85



TË DHËNAT PËR VITIN 2021

523,439 TON

Lënda e parë që është nxjerrë nga guroret tona aktive

2,981,754 EURO

Investime totale në vitin 2021

369,504 TON

Mergele – Dimçë

69,791 EURO

Të paguara për taksa lokale (komunale dhe në pronë)

0 TON

Mergele – Paldenicë

816,569 EURO

Tatime në të ardhura të korporatave

108,993 TON

RRESHPE – Gurore në Seqishtë

177,772 EURO

Kontributet pensionale të paguara për punonjësit (5% e kontributit të paguar nga Sharrcepi)

44,942 TON

Guri Gëlqeror - Gurore në Seqishtë

39,288,953 EURO

Shuma e parave që i është paguar furnizuesve për mallra dhe shërbime

628,867 TON

Prodhimi total i çimentos

159,071 EURO

Investimet totale (përfitimet sociale)

MESAZHI NGA DREJTORIMENAXHUES

Të nderuara Palë të Interesit,

Përshtatja dhe rimëkëmbja u shfaqën si dimensione thelbësore të veprimtarisë së Sharrcem SH.P.K në vitin 2021, duke marrë parasysh zhvillimet gjatë dy viteve të plota me pandemi. Pavarësisht sfidave të mëdha dhe tregjeve të paqëndrueshme, kemi kënaqësinë të raportojmë për progresin e arritur dhe rezultatet pozitive, konsolidimin e mëtejshëm të operacioneve dhe praktikave, dhe ndikimin më të gjerë në komunitetet të cilave u shërbejmë dhe mjedisin ku veprojmë.

Gjatë kohës së përpilimit të raportit vjetor për vitin 2021, bota tashmë po përballlet me paparashikueshmërinë shtesë që mund të ketë ndikimi i konfliktit në Ukrainë në situatën gjeopolitike dhe në ekonomi – veçanërisht në tregjet energjetike në mbarë botën. Ekonomitë evropiane po hyjnë në një fazë të vështirë, me rrezik të shtuar nga rritja e inflacionit dhe ngadalësimi të rritjes ekonomike. Implikimet nuk mund të vlerësohen ende, aq më tepër pasi Grupi i Çimentos TITAN nuk ndikohet nga ngjarjet në Ukrainë, Rusi apo rajonet e prekura. Megjithatë, në Sharrcem SH.P.K. kemi dëshmuar tashmë në praktikë se ne mund t'i përgjigjemi mjaft shpejt realiteteve të reja dhe të paparashikuara, dhe të qëndrojmë pranë vizionit dhe objektivave të kompanisë.

Për botën e biznesit, viti që lamë pas u shënuar me përpjekje të mëdha për t'u rimëkëmbur dhe për t'u rikthyer në rrugën e duhur pas pengesave nga pandemia COVID-19. Rritja pasuese e kërkesës, së bashku me mungesën e fuqisë punëtore kanë krijuar ndërprerje të zinxhirit të furnizimit, por nga ana tjetër, rritja e vazhdueshme e sektorit të ndërtimit në Kosovë në vitin 2021 ka rezultuar në një rritje të drejtpërdrejtë të kërkesës për çimento për rreth 4.5% krahasuar me vitin paraprak. Kurse Sharrcem SH.P.K. ka rritur shitjet afërsisht me të njëjtën përqindje. Nxitësit kryesorë për përdorimin e çimentos ishin ndërtimet të mbështetura fuqishëm nga trendet pozitive të migrimit, remitancat nga diaspora, normat e ulëta të interesit dhe disponueshmëria e parave, si dhe kushtet e mira atmosferike në përgjithësi gjatë muajve të dimrit.

Fitimi operativ (Fitimi i tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit – EBITDA) për vitin 2021 ishte 20% më i ulët krahasuar me periudhën paraprake të vitit 2020 pavarësisht rritjes së vëllimit të shitjeve me 5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Arsyeja ishte rritja e kostos së energjisë, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të vitit. Çmimi i energjisë elektrike në euro për kWh është rritur me 153% krahasuar me vitin 2020, ndërsa çmimi i Koksit të Naftës që është kostoja jonë kryesore për karburantin është rritur me 53%.

Shëndeti dhe Siguria mbeten prioritet kryesorë për Grupin e Çimentos TITAN dhe vizioni ynë është të kemi një mjedis pune të shëndetshëm dhe të sigurt, pa lëndime dhe pa incidente. Për këtë qëllim, Sharrceci ka kaluar në standardin ISO 45001, ka rritur përpjekjet për ndërgjegjësimin e punonjësve të vet të drejtpërdrejt dhe jo të drejtpërdrejt dhe ka kontribuar në përpjekjet e vendit duke qenë anëtar i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Përveç kësaj, ne punojmë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut siç përshkruhen në konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Që nga viti 2012, kur zbatuam një program intensiv për modernizim, Sharrcem SH.P.K. ka arritur të ndryshojë tërësisht ndikimin në mjedis nga operacionet e biznesit tonë, duke krijuar kushtet e duhura për përmirësimin e vazhdueshëm të qëndrueshmërisë mjedisore në të ardhmen. Një bazë e tillë e fortë përfshin certifikimin me standardin ISO 14001 për sistemin e menaxhimit mjedisor që është siguruar në vitin 2013, lejen e parë IPPC (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes) në Kosovë të siguruar në vitin 2014 dhe kontributin e dhënë nga Menaxheri ynë i Mjedisit në vitin 2013 në hartimin e strategjisë kombëtare të përshtatjes për Kosovën.

Ne ia atribuojmë rezultatet pozitive dhe përparimin e arritur në vitin 2021 promovimit të vazhdueshme të kulturës sonë në mbarë grupin. Kjo kulturë mbështetet në shtylla të forta që orientojnë dhe mbështesin të gjitha operacionet e biznesit: krijimi i vendeve të punës në komunitet, mjedisi, shëndeti dhe mirëqenia si dhe fuqizimi i të rinjve. Duke qenë pjesë e Grupit të Çimentos TITAN, Sharrcem SH.P.K. gjithashtu i përmbahet dhjetë parimeve të UNGC-së dhe ne raportojmë çdo vit për progresin e arritur në secilin parim.

Duke qenë anëtar i familjes së madhe të Grupit të Çimentos TITAN, Sharrcem SH.P.K. mbështet vlerat e tyre globale të përbashkëta. Këto vlera shtrihen veçanërisht në dimensionin e Përgjegjësisë Shoqërore Korporative (CSR) të operacioneve të biznesit tonë. Në të vërtetë, në vitin 2021 Rrjeti Kosovar CSR e shpërbleu Sharrcem SH.P.K. për iniciativat saj në fushën e qëndrueshmërisë. Këtë vit, Sharrcem SH.P.K. feston një tjetër moment historik të rëndësishëm, pasi është viti i dhjetë me radhë që përfshijmë CSR-në në raportin vjetor për palët e interesit. Në secilin raport, ne shohim se sa larg kemi arritur në aspektin e qëndrueshmërisë, përgjegjësisë mjedisore, qeverisjes, transparencës dhe përgjegjësisë sociale. Të gjitha këto

aspekte të kombinuara e bëjnë kompaninë tonë një lidere që jep një shembull jo vetëm brenda industrisë sonë, por edhe në sektorin e përgjithshëm privat.

Për Sharrcem SH.P.K., CSR-ja është e rrënjësuar në të gjitha fushat e veprimtarisë sonë. Përgjatë viteve, ne kemi krijuar dhe elaboruar struktura, politika dhe sisteme të menaxhimit për produktet, proceset dhe punonjësit tanë. Kemi bërë arritje solide të integritetit të CSR-së në operacione, investime, angazhim të komunitetit, transparencë publike dhe marrëdhënie me palët e interesit. Ky kontribut kanalizohet përmes tri shtyllave kryesore të CSR-së:

Krijimi i vendeve të punës, luftimi i papunësisë. Sharrcem SH.P.K., është partnere e autoriteteve komunale, institucioneve të arsimit formal dhe joformal, sektorit privat dhe komunitetit, për të zbatuar programe nga të cilat përfitojnë veçanërisht të rinjtë.

Përmes programeve të tilla ne u kemi mundësuar të rinjve të ftojnë aftësi të reja, të avancojnë njohuritë e tyre për të qenë konkurrues në tregun e punës, të krijojnë biznese (kryesisht në prodhimin e produkteve bujqësor) dhe të bëhen pjesëmarrës aktiv në aktivitete të ndryshme që plotësojnë nevojat e komunitetit lokal.

Fuqizimi i të rinjve. Shprehitë e mira zgjasin gjithë jetën nëse sjelljet ndryshohen herët. Ky parim orienton angazhimin tonë të drejtpërdrejtë me të rinjtë përmes fushatave të ndryshimit të sjelljes, skemave të mentorimit, trajnimit dhe praktikës që ne kemi zbatuar në bashkëpunim me shkollat publike, sektorin privat dhe organizatat donatore ndërkombëtare.

Mirëqenia dhe mjedisi. Sharrcem SH.P.K., merr seriozisht mirëqenien e komunitetit dhe përgjegjësinë mjedisore. Programet tona trajtojnë mirëqenien fizike së bashku me atë emocionale dhe mendore, duke i konsideruar njerëzit si pjesë e një ekosistemi të përgjithshëm. Aktivitetet në këtë shtyllë variojnë nga ndërgjegjësimi dhe kontrollet mjekësore për fëmijët e shkollave, mbështetja financiare për fëmijët më të cenueshëm, aksionet e dhurimit të gjakut dhe trajnimi për infermierët për efektet e COVID-19. Ne i zbatojmë vazhdimisht standardet për emetimet në ajër si dhe standardet e tjera përkatëse mjedisore.

Derisa hyjmë në vitin 2022, vizioni ynë largpamës vazhdon të fokusohet në qëndrueshmërinë, inovacionin dhe ndryshimin pozitiv për komunitetet me të cilat punojmë dhe në mjediset ku veprojmë.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time dhe të falënderoj për kontributin e dhënë të gjithë punonjësit në kompaninë tonë, grupin e palëve të interesit dhe komunitetin tonë.

Mbështetja e tyre është thelbësore për arritjen e qëllimeve tona dhe presim të kemi bashkëpunim të suksesshëm edhe vitin tjetër.



Mario Bracci
CEO

PËRSHËNDETJE NGA MANAXHMENTI

Ka qenë një privilegj i madh për mua që të më besohet gjatë 5 viteve të fundit udhëheqja e kompanisë Sharrcem SH.P.K., e cila bën pjesë në Grupit të Kompanive Titan, gjatë një periudhe vendimtare të operacioneve të saj jo vetëm drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë së biznesit, por edhe krijimit të hapësirës për rritje të qëndrueshme. Kjo periudhë u karakterizua veçanërisht me hapa të intensifikuar proaktivë për të përafruar operacionet me politikat e avancuara sociale dhe mjedisore, duke bashkuar vlerat e korporatës me përsosmërinë e biznesit, duke rezultuar në një mjedis të përmirësuar të të bërit biznes dhe kushte më të mira për komunitetin.

Duke parë atë që është arritur, mund të them me ndershmëri dhe krenari se ne i kemi mbajtur premtimet dhe kemi bërë më të mirën për të përmbushur qëllimet tona. Vlerat e përbashkëta të Grupit Titan në mbarë botën shërbyen si udhërrëfyes i palëkundur gjatë një udhëtimi të vështirë dhe na ndihmuan të qëndrojmë besnik ndaj parimeve tona thelbësore të praktikave etike të biznesit, transparencës, qeverisjes së mirë, duke u kujdesur gjithmonë për punonjësit tanë, komunitetin e gjerë dhe shoqërinë në përgjithësi.

Angazhimi ynë ndaj njerëzve, mjedisit dhe parimeve thelbësore të biznesit është i përjetshëm. Prandaj, ne japim vazhdimisht burime të shumta për të ruajtur vazhdimësinë e biznesit, duke përshpejtuar zhvillimin në afat më të gjatë.

Falë përkushtimit të punonjësve të kompanisë sonë dhe duke gëzuar mbështetjen e palëve të interesit, kemi arritur të përparojmë përtej planifikimit që kemi bërë, pavarësisht se kemi hasur në pengesa përtej kontrollit tonë, si pandemia COVID-19, ndryshimet e shpeshta në peizazhin lokal dhe në të bërit biznes, për të mos përmendur edhe zhvillimet e papritura në mbarë botën që kanë prekur rëndë aktivitetet sociale dhe ekonomike në industri në mbarë globin.

Arritjet tona kryesore janë nxitur nga objektivat themelore të biznesit, të tilla si rezultatet dhe performanca, njerëzit dhe talenti, qeverisja e korporatës dhe përgjegjësia sociale, siguria e punonjësve dhe ndikimi në mjedis, mundësitë e komunitetit dhe kontributi në axhendat e iniciativave globale, nga të cilat dëshiroj të nënvizoj në mënyrë indikative disa si më poshtë:

- Qëllimet e zgjerimit të biznesit
- Krijimi i vendeve të reja të punës
- Shembuj të masave për të garantuar sigurinë e punonjësve në punë
- Mundësi për zhvillimin e ekipeve
- Treguesit e diversitetit
- Aktivitetet dhe rrjetëzimi me palët e interesit
- Programet për komunitetin
- Kontributi në masat
- Arritja e qëllimeve lokale/globale të OZhQ-ve

Përveç arritjes së përsosmërisë në biznes dhe krijimit të më shumë mundësive për njerëzit tanë, është e rëndësishme të theksohet se aktivitetet tona operacionale kanë krijuar të ardhura të vlefshme për individët dhe kompanitë, duke pasur një ndikim të fuqishëm pozitiv në ekonominë lokale dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Megjithatë, ne mbetemi të përkushtuar ndaj angazhimit tonë të qëndrueshëm për të zbatuar dhjetë Parimet e UNGC-së dhe për të mbështetur zbatimin e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) që lidhen me vitin 2030, duke u fokusuar në ngritjen e ndikimit tonë pozitiv dhe zgjerimin e zbatimit të parimeve të UNGC në të gjithë zinxhirin tonë të furnizimit.

Sharrcem SH.P.K., së bashku me kompanitë tjera të Grupit Titan është orientuar për të naviguar me sukses sfidat që rrjedhin nga krizat e ndryshme botërore, qoftë financiare, shëndetësore, apo të tjera. Në anën tjetër, Kosova vazhdon të ketë një shkallë pozitive të rritjes ekonomike, një fuqi punëtore të re dhe energjike të cilës duhet t'i ofrohen mundësi dhe po bëhen përparime drejt stabilitetit. Prandaj, ne i kemi njerëzit, ne i kemi proceset e krijuara, ne i ndëtojmë aftësitë dhe shkathtësitë tona vazhdimisht si një organizatë që mëson dhe kemi besimin dhe mbështetjen nga palët e interesit dhe nga komuniteti.

Dëshiroj të falënderoj të gjitha grupet kryesore të interesit dhe kryesisht punonjësit tanë që ndajnë vlerat dhe qëllimet e Grupit të Çimentos Titan dhe do të vazhdojnë të shënojnë arritje të rëndësishme për të rritur operacionet tona të biznesit dhe për të kontribuar gjithnjë e më shumë në zhvillimin e vendit. Meqenëse kompania është në duar të mira dhe të besueshme, ka një arsye të mirë për të pritur rezultate më pozitive në vitet e ardhshme.

Sinqerisht,

Thomas Glavas
Drejtore Menaxhues

2017-2021

Angazhimi ynë ndaj njerëzve, mjedisit dhe parimeve thelbësore të biznesit është i përjetshëm. Prandaj, ne japim vazhdimisht burime të shumta për të ruajtur vazhdimësinë e biznesit, duke përsheptuar zhvillimin në afat më të gjatë.

Thomas Glavas
Drejtore Menaxhues



KUSH ËSHTË GRUPI TITAN

PËRMBLEDHJE

Një përmbledhje për Grupin tonë dhe strategjinë tonë në një mjedis global të ndryshueshëm. Qasja jonë për krijimin e vlerës për palët tona të interesit, procesi ynë i vlerësimit të materialitetit dhe objektivat tona ESG për vitin 2025 dhe më tej.

QASJA E BIZNESIT TONË NË NJË MJEDIS GLOBAL TË NDRYSHUESHËM

TITAN arrin 120 vjet përvojë në industri në vitin 2022 dhe angazhimi i tij për rritje të qëndrueshme bën pjesë në kulturën e tij dhe në angazhimin e mirëfilltë për qëndrueshmëri. TITAN është bërë një prodhues ndërkombëtar për prodhimin e çimentos dhe materialeve të ndërtimit, duke u shërbyer klientëve në më shumë se 25 vende përmes një rrjeti prej 14 fabrikash të integruara për prodhimin e çimentos dhe tri fabrikave për bluarjen e çimentos. TITAN ka gjithashtu gurore, fabrika të betonit, terminale si dhe objekte të tjera për prodhim dhe shpërndarje.



NJË GRUP VLERASH TË FORTA

Në Grupin TITAN, vlerat tona janë thelbi i asaj që jemi; ato orientojnë strategjinë tonë dhe ofrojnë bazën për të gjitha operacionet tona. Ato u kanë siguruar njerëzve tonë një lidhje të fortë dhe kanë mbështetur rritjen që na ka ndihmuar për më shumë se një shekull dhe kjo gjë buron drejtpërdrejt nga parimet, bindjet dhe vizioni i themeluesve tanë në vitin 1902. Ato mbeten baza solide e kulturës dhe shpirtit tonë familjar.

Integriteti

- Praktike etike në biznes
- Transparenca
- Komunikimi i hapur
- Qeverisja e mirë

Arritja e rezultateve

- Vlera e aksionarëve
- Objektiva të qarta
- Standarde të larta

Njohuritë

- Rritja e bazës së njohurive
- Mjeshtëri në çdo funksion
- Përsosmëri në detyrat kryesore

Përmirësimi i vazhdueshëm

- Organizim i të mësuarit
- Gatishmëria për ndryshim
- Ballafaqimi i suksesshëm me sfida

Vlera për Klientin

- Anticipation of customer needs
- Innovative solutions
- High quality of products and services

Përgjegjësia Shoqërore Korporative

- Siguria në rend të parë
- Zhvillim i qëndrueshëm
- Angazhimi i palëve të interesit

STRATEGJIA E GRUPIT

TRANSFORMIMI PËR ZHVILLIM

Strategjia e Grupit TITAN e orientuar drejt zhvillimit synon të shfrytëzojë mundësitë e paraqitura nga Dekarbonizimi dhe Digjitalizimi dhe të ofrojë materiale ndërtimi dhe zgjidhje që do të sjellin përfitime shtesë për klientët, punonjësit, furnizuesit dhe komunitetet tona.



ZHVILLIMI

Përdorimi i asetëve dhe zgjerimi
në burime të reja të zhvillimit



DEKARBONIZIMI

Prodhimi
Afërsia Tregtare



FURNIZIMI

Përmirësim i vazhdueshëm
Puna me Klientët



TALENTI

Aftësitë dhe organizimi



DIGJITALIZIM

Prodhimi
Zinxhiri i Furnizimit
Të dhënat e Klientëve

PRANIA GLOBALE

Ne raportojmë për performancën dhe aktivitetet tona bazuar në katër rajonet tona gjeografike, dhe ndaras për sipërmarrjen tonë të përbashkët në Brazil. on our joint venture in Brazil.



Produktet kryesore / aktivitetet kryesore



Çimento



Betoni i Gatshëm



Agregate



Llaç



Blloka ndërtimi



Hiri i thatë



Menaxhimi i mbeturinave dhe karburantet alternative


Numri i njësive operationale i të gjitha rajoneve siç është përlogaritur për qëllime të raportimit të performancës në fushën e ESG-së në nivel të Grupit

* Sipërmarrja e përbashkët në Brazil është përfshirë në pasqyrat financiare duke përdorur metodën e kapitalit të konsolidimit. Nuk janë përfshirë përmbljedhja e performancës ESG si dhe pasqyrat e sipërmarrjes së përbashkët në Brazil.

** Është përfshirë 1 objekt në Kanada

FOKUSIMI NË ÇËSHTJET MATERIALE

Ne po angazhohemi me palët tona të interesit në lokacionet tona për të kuptuar më mirë pritshmëritë dhe nevojave të tyre. Planifikimi i asaj që është më e rëndësishme për ta dhe për biznesin përmes një procesi të dyfishtë të materialitetit na ndihmon të zhvillojmë strategji të qëndrueshme për biznes dhe të krijojmë vlerë të cilat zgjasin.





LËVIZJA PËRPARA ME OBJEKTIVA AMBICIOZE NË FUSHËN ESG PËR VITIN 2025 DHE MË TEJ

Grupi TITAN ka vazhduar të përmirësojë performancën e vet afatgjatë të ESG-së dhe në vitin 2021 ka iniciuar një sërë objektivash Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse (ESG) për vitin 2025 dhe më tej, duke u fokusuar në katër fusha.

1

De-karbonizim dhe digjitalizim

3

Ndikimi Pozitiv në Mjedisin Lokal

2

Zhvillimi – Mundësi në Punë

4

Burime të Përgjegjshme



QEVERISJA E MIRË, TRANSPARENCA DHE ETIKA NË BIZNES

Me qeverisje të përshtatshme korporative, ne synojmë të sigurojmë që çdo vendim i menaxhimit të jetë në përputhje me qëllimin dhe vlerat tona kryesore, duke marrë parasysh faktorët tonë të qëndrueshmërisë dhe t'u shërbejë interesave më të mira të palëve tona të interesit. Duke identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar në mënyrë proaktive të gjitha rreziqet dhe mundësitë tona, ne sigurojmë që jemi të përgatitur për të arritur objektivat tona strategjike dhe për të adresuar çështjet që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjate të biznesit tonë.

MENAXHIMI I RREZIKUT

Grupi TITAN është aktiv në vende të ndryshme dhe kryen veprimtari të larmishme, duke u ekspozuar ndaj rreziqeve të mundshme, që përfshijnë rreziqet strategjike, të qëndrueshmërisë (ESG), operacionale dhe financiare.

Për të identifikuar dhe zbutur në mënyrë efektive ekspozimet e tilla, Grupi menaxhon rreziqet e tij në përputhje me praktikën ndërkombëtare për kompanitë industriale, duke përfshirë dimensionet kryesore të Menaxhimit të Riskut të Ndërmarrjeve (ERM) në proceset, sistemet dhe qeverisjen e tij. Në veçanti, pesë komponentët kryesorë të mëposhtëm të kornizës ERM mbështeten nga një sërë parimesh, duke siguruar bazën që Grupi të kuptojë dhe menaxhojë rreziqet që lidhen me strategjinë dhe objektivat e tij në biznes:




Qeverisja dhe vlerat

Duke përfshirë modelin e mbikëqyrjes, strukturat operative, përcaktimin e tipareve të dëshiruara kulturore, përkushtimin ndaj vlerave thelbësore dhe zhvillimin e shkathtësive të duhura;



Strategjia dhe përcaktimi i objektivave

Duke përfshirë përcaktimin e apetitit (niveLIN) e rrezikut, analizën e kontekstit, vlerësimin e opsioneve dhe formulimin e objektivave strategjike;




Performanca

Duke përfshirë identifikimin, vlerësimin dhe prioritizimin e rrezikut, zbatimin e përgjigjeve dhe krijimin e pamjes së portofolit të rrezikut;



Informacioni

Komunikimi i informacionit të rrezikut, përdorimi i TI-së dhe raportimi i performancës së rrezikut.



Rishikimi dhe shqyrtimi

Duke përfshirë rishikimin e rrezikut dhe performancës, vlerësimin e ndryshimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të qasjes;

KUSH ËSHTË SHARRCEMI

1936

Është themeluar Fabrika e Çimentos Sharrcem

1972

Modernizimi i parë në fabrikë me një furrë rrotulluese dhe ftohës të furrës ka rritur kapacitetin e saj deri në 180,000 ton në vit.

1980

Rritet kapaciteti i prodhimit pas investimeve të reja në furrën rrotulluese.

2000

Sharrcem përfshihet në planin shtetëror për privatizim dhe fillon periudha dhjetëvjeçare e qiradhënies.

2010

Grupi i Çimentos TITAN bën blerjen e Sharrcemit dhe fillon një plan ambicioz i modernizimit për t'i plotësuar standardet ndërkombëtare në cilësi, teknologji dhe mbrojtje të mjedisit.

2011

Sharrcemi e merr rolin udhëheqës në krijimin e Rrjetit CSR në Kosovë dhe angazhohet për të bërë investime për modernizim të plotë.

2012

Sharrcemi përfundon fazën e parë të modernizimit të teknologjisë dhe përmirëson efikasitetin e tij dhe ndikimin në mjedis. Fabrika siguron certifikimin e saj të parë për cilësi (ISO 9001) dhe zbaton Sistemin e Menaxhimit të Dioksidit të Karbonit. Kompania i shërben kryesisht tregut të Kosovës dhe bën shitje të herëpashershme në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

2013

Sharrcemi certifikohet edhe me ISO 14001 – Sistem për Menaxhimin e Mjedisit dhe OHSAS ISO 18001 – Sistem për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.

Përveç certifikimeve, Sharrcemi ka pranuar mirënjohje të rëndësishme në vitin 2013 për iniciativat e tij në fushën e CSR-së. Kompania ka zbatuar sistemin e shpalosjes së emetimeve përmes ueb-portalit për ta informuar publikun dhe për të raportuar për aksidente si dhe për CSR-në. Në aspektin e teknologjisë, është kryer Modernizimi i Procesit të Automatizimit si dhe është futur në përdorim Sistemi i Menaxhimit të Aseteve në Ndërmarrje (EAMS). Është publikuar Raportit i parë i CSR-së dhe Auditimi për CSR është kryer nga një organizatë e certifikuar dhe e pavarur.

2014

Sharrcemi siguron lejen IPPC – e para ndonjëherë e lëshuar në vend. Veç kësaj, Sharrcemi ka lansuar Këshillin Botëror të Biznesit (World Business Council) / projektin CSI (Iniciativa për Qëndrueshmëri në Industrinë e Çimentos) për inkuorimin e udhëzimeve të saj ndaj Kontraktuesve dhe në Sigurinë në Komunikacion.

Në aspektin e Shëndetit dhe Sigurisë, kompania ka organizuar kursin e parë NEBOSH në Ballkan për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (duke mos e përfshirë Greqinë), i cili është mbajtur në Kosovë. Është kryer dizajni inovativ për automatizimin e punës së vinçit në sallën e furrës dhe ky inovacion ka eliminuar pozitat e rrezikshme në punë si dhe pluhurin e tokës si dhe janë ndërmarrë shumë angazhime me Palët e Interesit për planin e saj ambicioz të investimeve me qëllim që vet ta bëjë prodhimin e karburantit. Është financuar LABi për të mundësuar vitin e parë të punës, duke përfshirë përkrahjen me burime të nevojshme administrative.

2015

Sharrcemi implementon zgjidhje inovative në linjën e prodhimit, ndërsa nis punët e rehabilitimit të gurores dhe fillon me iniciativën për tu certifikuar me SA 8000. Projekti LAB arrin frytet e para. 18 agro ndërmarrje të vogla dhe të mesme vendosin me sukses produktet e tyre në treg. Grupi Titan i bashkohet Paktit për të Rinjtë në Bruksel dhe përfaqësuesit e Sharrcemit kanë pasur kënaqësinë të marrin pjesë në atë ngjarje. 2016 - Sharrcemi certifikohet edhe me standardin SA 8000. Ky standard përkrahë përgjegjësinë dhe llogaridhënien shoqërore duke siguruar implementimin e sistemeve të besueshme të dizajnuara për të mbrojtur njerëzit dhe komunitetin. Veç kësaj, këtë vit janë implementuar dy projekte tjera. Është instaluar me sukses makina e re për ambalazhimin e paletave dhe puna ka filluar menjëherë duke përmirësuar shërbimet për klientë. Ndërkohë, Fabrika për Trajtimin e Ujërave të Zeza (WWTP) ka qenë një investim i madh që ka pasur për qëllim të përmirësojë cilësinë e ujit të derdhur në mënyrë që të kujdesemi për mjedisin dhe shëndetin e punonjësve të Sharrcemit dhe komunitetit në afërsi. Në përpjekje për të ofruar siguri dhe mirëqenie për punonjësit tanë si dhe për të aftësuar ata profesionalisht, është ofruar program i trajnimit nga VDZ përmes internetit për punonjësit në industrinë e çimentos, me anë të metodave të përziera të mësimi.



2017

Projekti ynë kryesor i Qëndrueshmërisë – LAB, ka siguruar dy grante:

1. Fuqizimi i Sektorit të Bujqësisë dhe Pemëtarisë në Han të Elezit – Granti është siguruar nga (USAID) për Zhvillim Bujqësor dhe Mundësi Rurale (AGRO) – qëllimi i projektit ishte zgjerimi i mbështetjes për 15 biznese të reja; dhe

2. Diversifikimi i Fermave në Përpunimin e Qumështit - Grant i siguruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) – një projekt që ka për qëllim diversifikimin e fermës dhe zhvillimin e biznesit. Nga investimet e bëra dhe nga performanca e lartë në punë e punonjësve tanë, rekordi më i lartë që nga viti 1936 është arritur gjatë këtij viti për sasinë e prodhimit të çimentos. Gjatë këtij viti raportues, Sharrceci është përzgjedhur si tatimpaguesi më i mirë në vend, si dhe Menaxheri ynë për Shëndet dhe Siguri ka qenë personi i parë i certifikuar nga Qeveria e Kosovës në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë

2018

Punonjësit e Sharrceci kanë përfituar nga platforma e re “unite people” dhe nga lansimi i planit të veprimit për diversitet dhe përfshirje i lansuar nga Grupi në vitin 2018. Gjatë këtij viti raportues, Sharrceci ka marrë shumë çmime dhe mirënjohje nga institucione dhe OJQ të ndryshme për angazhimin e tij ndaj shëndetit dhe sigurisë, mjedisit dhe CSR-së.

2019

Sharrceci u ri-certifikua me certifikatën SA 8000 dhe kjo certifikatë vlen deri në prill 2022. U prezantuan gjithashtu dy iniciativa të reja për të rinjtë: 1. Vlerësimi i tregut për mundësitë e punësimit, nga Sharrceci përmes LAB-it, në bashkëpunim me Sektorin e Kontraktimit të Proceve të Punës; dhe 2. Toka e dhënë / dhuruar për Komunën e Hanit të Elezit në mënyrë që të ndërtohet shtëpia e kulturës për të rinjtë. Si pjesë e përpjekjes sonë të vazhdueshme për të ofruar siguri, mirëqenie, dhe aftësim profesional për stafin tonë, në vitin 2019 Sharrceci organizoi trajnime për punonjësit e vet, përmes Institutit Austriak të Ekselencës.

Projekti LAB, i cili është projekti ynë kryesor i CSR-së, u pranua gjithashtu si praktika më e mirë nga International Journal of World Economy. Sharrceci mori një çmim për angazhim në aspektin e shëndetit dhe sigurisë gjatë javës Evropiane për shëndetin dhe sigurinë në punë.

2020

Është iniciuar projekti i ri me LAB - SPEEEX. Është zbatuar kalimi nga OHSAS 18001 në ISO45001 dhe u arrit ri-certifikimi me sistemin për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë nga (OHSAS 18001 në ISO45001) Eurocert.

2021

Në raportin e parë vjetor në vitin 2012, Sharrceci ishte zotuar të vazhdojë me prezantimin e raportit vjetor në vazhdimësi. Këtë vit, ne festojmë me krenari 10 vjetorin e një raportimi të tillë vjetor. Në vitin 2021, Sharrceci mori çmimin “Tatimpaguesi i Vitit 2021” nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Autoritetet Doganore. Në vitin 2021, kompania kaloi nga standardi për shëndetin dhe sigurinë OHSAS 18001 në ISO 45001. Prandaj, Departamenti ynë i Shëndetit dhe Sigurisë arriti njohuritë dhe ekspertizën përkatëse për të mbështetur më tej kompaninë në planifikimin dhe zbatimin e procesit të kalimit nga standardi OHSAS 18001 në ISO 45001 në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur.

Sharrceci inicioi në nivel lokal SAP-në të Grupit të Çimentos TITAN. Ky projekt do t'i mundësojë Sharrceci të menaxhojë proceset komplekse të biznesit në mënyrë më efektive dhe të shtyjë përpara integrimin e operacioneve të veta me ato të Grupit të Çimentos TITAN. Rrjedhimisht, kompania do të përshpejtojë fluksin e punës, do të përmirësojë efikasitetin, do të rrisë produktivitetin dhe do të jetë në gjendje të ofrojë shërbime të përmirësuara ndaj klientëve.



SHARRCEMI SOT

Historia e Sharrcemit filloi në vitin 1936. Gjithçka filloi me një furrë vertikale që kishte një kapacitet prodhimi prej 4,415 tonë në vit.

Sharrcemi ka bërë shumë përparime deri më sot jo vetëm me kapacitete të prodhimit, por edhe në mënyrën se si kompania i qaset konceptit të të bërit biznes. Sharrcem beson se tani, të bërit biznes është më shumë sesa thjesht të fitosh. Në aktivitetet dhe operacionet tona të përditshme, ne marrim parasysh shqetësimet si ndryshimi i klimës, pabarazia ekonomike ose kushtet tjera që mund të prekin njerëzit dhe komunitetet tona. Ne zbatojmë standardet më të larta për të garantuar qeverisje të mirë, integritet dhe sjellje etike në biznes, duke qenë gjithmonë një organizatë e orientuar nga qëllimi, dhe duke bërë investime të vazhdueshme në çështje që janë të rëndësishme për qëndrueshmërinë e biznesit dhe palët kryesore të interesit, në varësi të biznesit ose që ndikojnë në biznes.

I orientuar nga një angazhim i përbashkët i kompanisë për rritje të qëndrueshme, Sharrcemi bashkon përvojën e vet të fituar në industri gjatë shumë viteve duke punuar me strategji progresive për t'i shtuar vlerë zgjidhjeve të qëndrueshme.

Për Sharrcemin, blerja nga Grupi i Çimentos TITAN ishte një ngjarje shumë e rëndësishme në historinë e saj. Si rezultat, kompania arriti të përmirësojë ndjeshëm kapitalin e saj intelektual, prodhues dhe njerëzor. Duke bërë këtë, Sharrcemi forcoi më tej kapacitetet e veta për të krijuar vlera afatgjata për palët e interesit, komunitetet dhe vetë biznesin. Në vizionin e Sharrcemit, qëndrueshmëria është e një rëndësie të madhe për kohën në të cilën po jetojmë. Prandaj, ne kemi ngulitur thellë përgjegjësinë sociale dhe praktikën e qëndrueshmërisë në operacionet dhe frymën tonë të punës.

Grupi i Çimentos TITAN është i përfshirë nga afër në iniciativat më të fundit në fushën e qëndrueshmërisë. Në vazhdimësi, praktikën dhe iniciativat e Sharrcemit janë krijuar me qëllimin për të kontribuar në zgjidhjet e qëndrueshmërisë, me theks të veçantë në nivelin lokal. Kjo është arsyeja pse ne e konsiderojmë anëtarësimin në organizata ose rrjete përkatëse si një hap të rëndësishëm në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave dhe ofrimin e vlerës për palët e interesit, dhe ne punojmë vazhdimisht me zell për të qenë të njoftuar me zhvillimet globale në këtë fushë.

Sharrcemi beson në vlerën e auditimeve të plota të kryera nga aktorë të ndryshëm si një mjet për të demonstruar përkushtimin e vet dhe për të siguruar përputhshmërinë e plotë me ligjin dhe rregulloret kombëtare në lidhje me arritjen e qëndrueshmërisë solide nga iniciativat të veta për vlerësimin e performancës.

Në këtë vit raportues, Sharrcemi ka pasur disa vizita nga institucione të ndryshme shtetërore, të organizuara me qëllim të verifikimit të gjendjes në terren.

Si rezultat i përkushtimit të kompanisë dhe niveleve të performancës, në këtë vit raportues, si Ministria e Financave ashtu edhe Autoritetet Doganore të Kosovës e kanë shpallur Sharrcemin ndër tatimpaguesit më të mirë të vitit.

Zvogëlimi i ndikimit në mjedis është një nga qëllimet kryesore të përgjithshme të biznesit dhe në veçanti nga përpjekjet e gjelbra të Sharrcemit. Së bashku me përpjekjet e vazhdueshme për të rritur kulturën e sigurisë brenda dhe jashtë kompanisë, kjo strategji kontribuon ndjeshëm në mirëqenien e punonjësve, komunitetit e afërsi dhe shoqërisë në përgjithësi.

OPERACIONET E SHARRCEMIT

Sharrcemi është fabrika e vetme e çimentos në Kosovë. Ndodhet pranë kufirit me Maqedoninë e Veriut. Kompania ka selinë e saj në qytetin kufitar të Hanit të Elezit, dhe dy filiale në Prishtinë dhe Shkup. Sharrcemi vazhdon të përdorë vetëm transportin rrugor për shpërndarjen e produkteve të veta.

Sipërmarrjet e Përbashkëta

SELIA E FABRIKËS	ZYRA NË RISHTINË	ZYRA NË SHKUP	TERMINALET
Sharrcem SH.P.K. Adem Jashari 280 71510 Hani i Elezit Kosovë Tel. 00383 38 768 000 contact@sharrcem.com	Representative Office në Pr. Tringe Smajli 21 10000 Prishtinë Kosovë Tel. 00383 38 777 011	Representative Office në Sk. Mitropolit Teodosij Gologanov 32 1000 Shkup Maqedoni e Veriut Tel. 0038923111544	Terminal in Duhle Duhël 23000 Suharekë Kosovë Terminal in Klina Magjistralka Prishtinë – Pejë 32000 Klinë Kosovë

SHARRCEM ËSHTË ANËTARE NË:



Odën Ekonomike të Kosovës



Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare



Rrjetin CSR në Kosovë



Rrjetin e Investitorëve Evropian



KOSHA




CIGRE

AKTIVITETI I SHARRCEMIT NË BORDE/KËSHILLA:

Këshilli Nacional për Shëndet dhe Siguri në Punë

Rrjeti CSR në Kosovë

Këshilli i Investitorëve Evropian



PRODUKTET TONA

Sharrcem ka reputacion të lartë për sjellje korrekte. Zinxhiri dhe rrjeti i organizuar i furnizimit demonstrojnë një qëndrueshmëri dhe zhvillim solid të biznesit. Klientët, kontraktuesit dhe furnizuesit janë pjesë shumë e rëndësishme në aktivitetin e biznesit tonë. Sharrcem ka krijuar politika dhe procedura specifike për prokurim dhe rekrutim.

Sa herë që kushtet e lejojnë këtë, kompania u jep përparësi palëve vendore të interesit në kushte konkurruese, duke respektuar gjatë gjithë kohës Sistemet e Menaxhimit të Çertifikuar Ndërkombëtar dhe Evropian.

Vlera e Zinxhirit

Sharrcemi është pjesë e një zinxhiri më të gjerë vlerash brenda kufijve të vendit që u shërben nevojave të shoqërisë për strehim dhe ndërtim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të përballueshëm. Aktivitetet kryesore të kompanisë përfshijnë prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e çimentos, hirit të thatë dhe lëndëve të tjera të para. Procesi i prodhimit në fabrikën e çimentos në Han të Elezit përbëhet nga këta hapa: shtypja, homogjenizimi, bluarja, ngrohja dhe ftohja e lëndës së parë për të prodhuar klinker (zgjyrë) e cila pastaj përpunohet më tej për të prodhuar produktin përfundimtar të çimentos. Lënda e parë, siç është guri gëlqeror, nxirret nga dy guroret aktive të Sharrcemit në Dimcë dhe Paldenicë. Përveç kësaj, për prodhimin e çimentos ne përdorim lëndën e parë alternative si hiri fundërrues, hiri i thatë dhe hiri i piritit, të cilat prodhohen nga industritë e tjera të Kosovës me qëllim të zvogëlimit të ndikimit mjedisor dhe rritjes së eko-efikasitetit. (Për të dhëna dhe fakte, ju lutemi lexoni më shumë në faqen 50)



KLIENTËT TANË

Sharrcem është pozicionuar siç duhet në treg përmes produkteve të saj me cilësi të lartë dhe qasjes profesionale me klientët. Për të arritur një pozitë të tillë prestigjioze dhe të besueshme, kompania ka bërë investime të rëndësishme në teknologji, burime njerëzore dhe projekte, të cilat përfundimisht kanë ndikuar pozitivisht në optimizimin e procesit, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e komunitetit si dhe në shëndetin dhe sigurinë në punë. Ne kemi komunikim dhe bashkëpunim të rregullt me klientët, duke siguruar që të zbatojmë gjatë gjithë kohës standardet më të larta në industri.

Projekti: Ngarkimi Automatik

Në fund të shtatorit 2021, kemi kryer me sukses automatizimin e ngarkimit të çimentos. Falë këtij projekti, tani shoferët mund të shtypin urdhrin e ngarkimit duke përdorur etiketën e tyre të identifikimit të personalizuar, dhe të shkojnë tek stationi i ngarkimit. Më pas, shoferët mund të ngarkojnë çimenton duke përdorur etiketën e tyre të identifikimit, bazuar në porosinë e mëparshme elektronike të bërë me emrin e tyre në Ueb Portalin e Klientit. Ky projekt ka përmirësuar procesin e ngarkimit të çimentos i cili është përdorur për refuz dhe çimento në thasë.

Komentet Kthyesë nga Klientët

Për të siguruar kënaqësinë e vazhdueshme të klientëve, Sharrcem ka krijuar një proces të duhur për të vlerësuar komentet kthyesë të klientëve përmes pyetësorëve. Pyetësori i klientëve është një mjet i dobishëm dhe i konsoliduar për të kuptuar mendimet e klientëve sa i përket bashkëpunimit të tyre me Sharrcemin në çështje të ndryshme, duke filluar nga cilësia e produkteve, bashkëpunimi me departamentet e Sharrcemit, kushtet e ngarkimit dhe kohës së pritjes për ngarkim.

Cilësia e Çimentos	Cilësia e Sharrmallit	Paletat	Foljet	Thasët	Shton vlerë në porositjen e çimentos	
55%	63%	70%	70%	63%	63%	😊
42%	33%	26%	22%	26%	26%	😐
3%	4%	4%	7%	7%	7%	😞
-	-	-	-	4%	4%	😡

SISTEMET E MENAXHIMIT

Ofrimi i kushteve të përshtatshme të punës për të gjithë punonjësit është i domosdoshëm për kompaninë tonë. Për të siguruar që ne asnjëherë të mos bëjmë kompromis me këtë zotim, ne kemi zbatuar në tërësi Sistemet e Menaxhimit të Çertifikuar Ndërkombëtare dhe Evropiane. Në fakt, Sharrcem është kompania e parë në Kosovë që ka siguruar lejen IPPC (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes), sipas Direktivës së Bashkimit Evropian dhe leja është lëshuar nga Qeveria e Kosovës. Sharrcem është gjithashtu kompania e parë në Kosovë që ka siguruar Çertifikimin Eurocert për standardin SA 8000 për Përgjegjësi Sociale. Përveç kësaj, Sharrcem ka krijuar Laboratorin për Aktivitete të Biznesit (LAB), i cili siguron mbështetje financiare dhe teknike për të gjitha përpjekjet për krijimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Përmes LAB-it, Sharrcemi ka adresuar disa nga çështjet më kritike që prekin komunitetin tonë. Sharrcemi është i vendosur të kontribuojë në prosperitetin e vendit duke bërë biznes bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare të industrisë, duke ndërmarrë një sërë iniciativash dhe duke marrë përgjegjësinë drejt nxitjes së një tregu të drejtë dhe transparent.

PIKA	SISTEMI I MENAXHIMIT / CERTIFIKIMI	STATUSI
Të gjitha Produktet / Llojet e Çimentos	CEM I 52.5 N	✓
	CEM II/B-M (W-L) 42.5 R	✓
	CEM II/B-M (W-P-L) 42.5 N	✓
	CEM IV/B (P-W) 32.5 R	✓
EN 197-1: 2011		
Ndikimi në CO ₂	Sistemi i menaxhimit të CO ₂	Inkorporuar në EMS ISO
Mjedisi	Sistemi i menaxhimit të ujit	Inkorporuar në EMS ISO
Mjedisi	ISO 14001	✓
Cilësia	ISO 9001:2015	✓
	SHENJA CE	
	Akreditimi ISO 17025:2018	
Siguria	ISO 14001	✓
Llogaridhënia	Përgjegjësia Sociale / SA 8000	✓
Financat	Auditimi i kryer në mes të vitit	✓
Raportimi për ESG	Garancia e pavarur e kufizuar dhe e nivelit të avancuar sipas kërkesave të UNGC-së	✓



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
DHE INFRASTRUKTURËS



SHPËRNDARJA E VLERËS PËR TË GJITHË

Duke qenë e frymëzuar nga veprimi kuptimplotë i Grupit të Çimentos TITAN, kompania Sharrcem ka përdorur burime të rëndësishme të kompanisë për të krijuar vlerë për palët e saj të interesit dhe për të kontribuar drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së për vitin 2030. Ne besojmë fuqimisht se zhvillimi i Sharrcemit është i qëndrueshëm vetëm kur shoqërohet me një zhvillim proporcional të komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi, dhe ne punojmë çdo ditë për të arritur këtë qëllim.

**Investimet totale në
vitin 2021**

2,981,754 €

Taksat lokale të paguara

(Komunale dhe të pronës, të paguara)

69,791 €

**Tatime në të ardhura
të korporatave**

816,569 €

**Kontributet pensionale të
paguara për punonjësit**

(5% i kontributit i paguar nga Sharrcem)

177,772 €

Investimet totale

(përfitimet sociale)

159,071 €

**Investimet në mjedis,
si dhe në shëndet
dhe siguri në punë**

457,716 €

VLERËSIMI I MATERIALITETIT

ÇËSHTJET MATERIALE

Çështjet materiale po zënë gjithnjë e më shumë vend të rëndësishëm në çdo strategji koherente, gjithëpërfshirëse dhe konsistente për qëndrueshmëri të biznesit. Për të siguruar konsistencën e iniciativave të qëndrueshmërisë në të gjithë grupin, në vitin 2021 Grupi i Çimentos TITAN kreu një vlerësim gjithëpërfshirës për të gjitha iniciativat e Sharrcemit. Qëllimi i këtij vlerësimi ishte të identifikonte nëse këto iniciativat të qëndrueshmërisë plotësonin një nivel adekuat ose të lartë të harmonizimit me çështjet materiale të rëndësishme si për palët e interesit ashtu edhe për aktivitetet e afarizmit në nivel të njësisë së biznesit.

Grupi i Çimentos TITAN ka përdorur metodologjinë e Kornizës së Bordit të Standardeve të Qëndrueshmërisë në Kontabilitet (SASB) për Vlerësimin e Materialitetit si mjet kryesor për të analizuar lidhjen midis çështjeve materiale dhe iniciativave. Më pas, fusha e Kapitalit Social u rendit si çështja materiale më e rëndësishme për njësitë e saj të biznesit nëpërmjet iniciativave të përfshirjes së komunitetit, e ndjekur nga Kapitali Njerëzor, veçanërisht për përfshirjen dhe mirëqenien e punonjësve të kompanisë.

Sipas ciklit të Vlerësimit të Materialitetit të Sharrcemit që është mbajtur në 2020, janë adresuar tetë çështje të rëndësishme materiale të grupuara në katër Fushat e Fokusit të Grupit të Çimentos TITAN dhe të gjitha janë të mbështetura nga qeverisja e mirë, transparenca dhe etika në biznes.

Çështjet materiale të identifikuara u renditën në bazë të ndikimit dhe rëndësisë së tyre për palët e brendshme dhe të jashtme të interesit.

PALËT E INTERESIT

Punonjësit

Klientët

Komunitetet dhe qeveritë lokale

Rregullatorët, Autoritetet

Aksionarët

Partnerët dhe Furnizuesit e Biznesit

Kontraktuesit

Autoritetet Lokale

Investitorët dhe Analistët

OJQ-të

Rinore

Shoqëria Civile

Media

Akademi dhe Kërkim

Procesi ynë konfirmoi se mjedisi i sigurt dhe i shëndetshëm i punës për të gjithë, performanca mjedisore, angazhimi dhe kontributi për komunitetet tona lokale janë në krye të listës së çështjeve materiale Sharrcem

FUSHAT KU ËSHTË FOKUSUAR GRUPI TITAN



Dekarbonizimi dhe Digjitalizimi

- Dekarbonizimi dhe Digjitalizimi



Qeverisja

- Qeverisje e Mirë, Transparenca dhe Etika e Biznesit.



Burime të Përgjegjshme

- Zinxhir i furnizimit i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm



Zhvillimi – Mundësi në Punë

- Mjedisi i sigurt dhe i shëndetshëm i punës për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit përgjatë zinxhirit të vlerës

- Përfshirja dhe zhvillimi i punonjësve

- Vend i punës i larmishëm dhe gjithëpërfshirës



Ndikimi Pozitiv në Mjedisin Lokal

- Performanca mjedisore
- Angazhimi dhe kontributi për komunitetet tona lokale

Kompania e Çimentos TITAN ka vendosur objektiva ambicioze Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse (ESG) për vitin 2025 dhe më tej, siç paraqitet në raportin e tyre. Këto objektiva nënvizojnë angazhimin e kompanisë për qëndrueshmërinë dhe krijimin e vlerave për të gjithë, me theks të veçantë në katër shtylla:

- 1

Dekarbonizimi dhe digjitalizimi
- 2


Zhvillimi – Mundësi në Punë
- 3

Ndikimi Pozitiv në Mjedisin Lokal
- 4

Burime të Përgjegjshme

Të gjitha këto shtylla mbështeten nga qeverisja e mirë, transparenca dhe etika në biznes. Duke pasur mbështetjen e palëkundur të Grupit të Çimentos TITAN dhe në veçanti, të Departamentit të Grupit për Performancë në fushën e ESG-së, Sharrcepi ka ndërtuar aftësi dhe shkathtësi të mjaftueshme për të menaxhuar, monitoruar dhe raportuar performancën e lidhur me qëndrueshmërinë. Sharrcepi ka përcaktuar objektivat në përputhje me çështjet materiale më të rëndësishme të cilat janë identifikuar pas rezultateve nga procesi i vlerësimit të materialitetit i mbajtur në vitin 2020, duke u mbështetur në përkufizimin e dhënë nga Objektivat e Qëndrueshmërisë së Grupit TITAN për vitin 2025 dhe 2030.

MATRICA E MATERIALITETIT 2021-2025



↑ RËNDËSIA QË KANË PËR PALËT E INTERESIT

- 1

Mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm i punës për punonjësit tanë dhe partnerët e biznesit përgjatë zinxhirit të vlerës
- 4

Qeverisje e mirë, transparencë dhe etikë në biznes
- 7

Vend i punës i larmishëm dhe gjithëpërfshirës

→ RËNDËSIA QË KANË PËR SHARRCEMIN

- 2

Performanca Mjedisore
- 2

Angazhimi dhe kontributi në komunitetet tona lokale
- 5

Përfshirja dhe zhvillimi i punonjësve
- 6

Ndryshimi klimatik dhe efienca në energji
- 8

Zinxhir i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm i furnizimit

OZHQ-TË PËRKATËSE TË OBK-SË QË LIDHEN ME ÇËSHJET MATERIALE TË SHARRCEMIT

Vlerësimi i materialitetit siguron një lidhje të qartë midis çështjeve materiale të identifikuara si të rëndësishme dhe mënyrës se si këto çështje janë të lidhura me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), të përcaktuara nga OKB-ja për të arritur rritje dhe zhvillim afatgjatë deri në vitin 2030. Të gjitha vendet, duke përfshirë Kosovën, janë angazhuar vullnetarisht për të përbushur këto objektiva globale dhe në këtë Raport, Sharrcemi fokusohet në çështjet materiale që do të trajtohen deri në vitin 2025 dhe të cilat lidhen me thirrjen globale për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së për vitin 2030. Përgjegjësia sociale dhe bashkëpunimi për një të ardhme më të qëndrueshme vazhdojnë të nxisin veprimet, iniciativat dhe investimet e planifikuara nga Sharrcemi.

Çështjet materiale 2021 - 2025

Mjedis i Sigurt dhe i Shëndetshëm për Punë

Kontributi në CSR



Performanca Mjedisore



Angazhimi dhe Kontributi



Qeverisja e mirë, Transparenca dhe Etika në Biznes



Angazhimi i Punonjësve



Ndryshimi Klimatik dhe Eficienca në Energji



Vend i punës i Larmishëm dhe Gjithëpërfshirës



Zinxhir i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm i furnizimit



PROCESI I VALIDIMIT PËR ÇËSHJTJET E MATERIALITETIT

Marrja e komenteve nga palët tona të interesit është pjesë e validimit dhe përfshirjes që Grupi e zbaton dhe në këtë mënyrë siguron një dialog të vazhdueshëm me palët lokale të interesit. Nëpërmjet këtij procesi të validimit, Sharrcemi ua komunikon çështjet materiale palëve kryesore të interesit siç janë prioritetizuar në vitin 2021 dhe kërkon mendime dhe komente konstruktive që do të ndihmojnë në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm në vitet e ardhshme.

RAPORTI I MENAXHMENTIT

STRUKTURA QEVERISËSE, BORDET, DHE ROLET E TYRE

Sharrcemi ka një strukturë kolektive të qeverisjes. Bordi Menaxhues është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të arritur qëllimin e kompanisë. Bordet dhe komitetet tjera sigurojnë zbatimin e planeve dhe objektivave të kompanisë, të tilla si struktura e CSR-së, politikat dhe procedurat; kujdesi për njerëzit, shoqërinë dhe mjedisin; mbajtja e komunikimit me punonjësit dhe palët tjera përkatëse të interesit, dhe të kryejë, lehtësojë dhe monitorojë angazhimin me komunitetin lokal.

Struktura Ligjore e Sharrcemit

Sharrcem SH.P.K. është kompani private në pronësi të Grupit të Çimentos TITAN që nga viti 2010. Sharrcemi e zhvillon biznesin në mënyrë etike dhe transparente, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë, dhe në përputhje me udhëzimet dhe politikat e Grupit të Çimentos TITAN. Selia e menaxhmentit të kompanisë është në Kosovë.



Këshilli i Njësisë
Biznesore (BU) për
Shëndet dhe Siguri



Këshilli i BL-së
për Shëndet
dhe Siguri



Këshilli për
Mjedis



Bordi për
Kontrollin e
Cilësisë




Komiteti për
CSR



Komiteti për
SA 8000

STRUKTURA E SHARRCEMIT PËR QEVERISJE TË QËNDRUESHME



STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMITETIT PËR CSR



PRIORITETET

Vëmendja e afërt dhe e kujdesshme ndaj njerëzve, shoqërisë dhe mbrojtjes së mjedisit mbetet në krye të listës prioritare të menaxhmentit të Sharrcemit.

Kompania është plotësisht e përkushtuar ndaj iniciativave që rrisin ndërgjegjësimin në mënyrë që të gjithë anëtarët e shoqërisë të mund të punojnë së bashku për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë.

 SIGURIA Fokusi në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë, integritetin fizik dhe mendor të punonjësve tanë të drejtpërdrejt dhe jo të drejtpërdrejt, brenda dhe jashtë vendit të punës.	Investimi në staf, si dhe takime dhe programe trajnimi për zbatimin e udhëzimeve të CSI-së.
 NJERËZIT Sigurimi i kushteve të duhura të punës që mbështesin punonjësit në ruajtjen e një ekuilibri të shëndetshëm mes punës dhe jetës, sigurimi i trajtimit të barabartë për të gjithë punonjësit, respektimi i diversitetit dhe krijimi i një mjedisi në vendin e punës që mbështet zhvillimin dhe mësimin e vazhdueshëm.	Programet e trajnimit, përmirësimi i vazhdueshëm, plani për zhvillimin e punonjësve.
 PËRSOSMËRIA dhe INOVACIONI Përmeshja e standardeve të larta të qëndrueshmërisë përmes sistemeve të certifikuara, në proceset industriale, produkte, shërbime dhe rezultate financiare, zhvillimi i një mendje kureshtare, nismës dhe përshtatshmërisë si dhe zbatimi i zgjidhjeve të zgjuara në kuadër të operacioneve tona.	Komunikimi, eventet dhe ngritja e vetëdijesimit.
 RESPEKTI Angazhim i vazhdueshëm me të gjitha palët tona të interesit.	Shpalosjet dhe transparencë.
 KLIENTËT Të sigurohet që të kemi klientë të kënaqur duke krijuar komunikim të hapur dhe të qartë dhe duke ndërtuar marrëdhënie.	Takime dhe programe trajnimi për zbatimin e udhëzimeve të CSI-së.
 KONTRAKTUESIT DHE FURNIZUESIT Të sigurohet që kontraktuesit të respektojnë rregullat e kompanisë.	Takime dhe programe trajnimi për zbatimin e udhëzimeve të CSI-së, SA 8000, trajnim i vazhdueshëm për ngritjen e vetëdijesimit.
 KOMUNITETI DHE SHOQËRIA Fokusimi në çështjet materiale të komunitetit dhe të vendit.	Fuqizimi i bordit këshillëdhënës lokal të pavarur - BOPAL, mbështetje e vazhdueshme dhe e fortë për projektin LAB, mbështetje dhe kontribut në Rrjetin CSR në Kosovë, në institucionet ndërkombëtare, bashkëpunimi i vazhdueshëm, kontributi në edukimin në nivelin lokal dhe kombëtar, eventet dhe ngritja e vetëdijesimit.
 MJEDISI Fokusi në zvogëlimin e vazhdueshëm të ndikimit të karbonit në operacionet tona dhe pjesëmarrja në dekarbonizimin e zinxhirit të vlerës së ndërtimit.	Përmirësimi i vazhdueshëm, bashkëpunimi i ngushtë me autoritetet dhe programe të trajnimit.
 QËNDRUESHMËRIA Vazhdimi i të bërit biznes brenda parimeve të qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë shoqërore të korporatës.	Vazhdimi i rritjes së vetëdijesimit lidhur me CSR-në brenda kompanisë, komunitetit dhe më gjerë.

SHQYRTIMI I PERFORMANCËS NË FUSHËN E ESG-SË

Në vitin 2021, përpjekjet e Sharrcemit për të krijuar projekte të qëndrueshmërisë që bashkojnë përpjekjet dhe angazhimin e të gjitha palëve kanë arritur në një nivel të rëndësishëm. Kjo arritje u bë e mundur përmes një ndërthurje organike të kontributit kuptimplotë të Grupit të Çimentos TITAN në nivel global së bashku me përpjekjet e Sharrcemit për angazhimin e akterëve kryesorë lokal përmes marrëdhënieve transparente dhe vlerave të përbashkëta. Prandaj, veprimet e Sharrcemit në drejtim të qëndrueshmërisë së operacioneve të veta arritën gjatë vitit raportues në një nivel të pjekurisë ku veprimet dhe planifikimi i qëndrueshmërisë nuk janë më çështje negociatash, por përpjekje e përbashkët me angazhim absolut, në radhë të parë nga komuniteti i Hanit të Elezit së bashku me institucionet shtetërore, partnerët e biznesit dhe punonjësit e Sharrcemit.

Sharrcemi vazhdon t'i kushtojë vëmendje të madhe njerëzve, shoqërisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Fokusi kryesor i Sharrcemit këtë vit ishte mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë, integritetit fizik dhe mendor të punonjësve tanë të drejtpërdrejt dhe jo të drejtpërdrejt, brenda dhe jashtë vendit të punës. U organizuan dhe u zbatuan iniciativa të ndryshme për të siguruar kushte të përshtatshme pune që mbështesin punonjësit në ruajtjen e një ekuilibri të shëndetshëm mes punës dhe jetës, sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë punonjësit, respektimin e diversitetit dhe krijimin e një mjedisi pune që mbështet zhvillimin dhe mësimin e vazhdueshëm. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Sharrcemi raportoi se nuk kishte asnjë lëndim me kohë të humbur në punë (LTI) gjatë vitit 2021.

FUSHA NË FOKUS: DEKARBONIZIMI DHE DIGJITALIZIMI


Çështjet materiale: Ndryshimi klimatik dhe efienca në energji

NDRYSHIMI KLIMATIK


Ndryshimi i klimës vazhdon të konsiderohet si sfida më e rëndësishme mjedisore e kohës sonë. Industria e prodhimit të çimentos është e tillë që prodhon dhe emeton dioksid karboni (CO₂), duke kontribuar kështu në efektin serë dhe në ndryshimin e klimës. Për t'iu kundërvënë efekteve të tilla, Sharrcemi vazhdimisht përpaket të adresojë sfidat e përcaktuara mjedisore përmes planifikimit të kujdesshëm dhe ndërmarrjes së veprimeve, të shoqëruara me investimet e nevojshme. Në vitin 2013, Sharrcemi i përfaqësuar nga Menaxheri i tij për Mjedis, duke vepruar si konsulent kombëtar, mori pjesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes për Kosovën.

Përveç kësaj, është themeluar një ekip shkencor për të mbështetur Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës për të kontribuar në ngritjen e kapaciteteve dhe harmonizimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata. Sharrcem zbaton strategjinë e Grupit të Çimentos TITAN për zvogëlimin e ndikimit në ndryshimet klimatike e cila pasqyrohet hollësisht edhe në politikën mjedisore dhe ajo e orienton udhërrëfyesin e Grupit tonë për dekarbonizim. Në vitin 2020, kemi arritur të zvogëlojmë emetimet tona specifike të CO₂, kryesisht për shkak të zvogëlimit të faktorit të klunkerit (zgjyrës) në çimento, dhe kjo është arritur duke përdorur sasi të shtuara të lëndëve të para alternative dhe të përshtatshme.

Emetimi Total Bruto i CO₂ (ktCO₂)



Emetimi Specifik Neto i CO₂ (kgCO₂/tCementitos)



Në fokus të strategjisë së grupit Titan për procesin e dekarbonizimit në vitin 2021, për herë të parë është filluar me monitorimin dhe raportimin e emetimit të CO₂ në Nivelin 3 (Fushëveprimi 3) dhe me grumbullimin e të dhënave.

Emetimi i CO₂ në Nivelin 3 (Fushëveprimi 3) i referohet burimeve në vijim:

Emetimi lidhet me

- Mallrat dhe shërbimet e blera
- Aktivitetet e lidhura me karburantin dhe energjinë
- Transportimi dhe shpërndarja për furnizim
- Transportimi dhe shpërndarja për shpërndarje

Kategoritë

Niveli i Emetimit të CO₂

1 Mallrat dhe shërbimet e blera	14,081 t	26.8%
2 Aktivitetet e lidhura me karburantin dhe energjinë	24,950 t	47.4%
Karburanti i blerë	1,590 t	
Transportimi i karburantit për furnizim	201 t	
Energjia e blerë	23,159 t	
4 Transportimi dhe shpërndarja për furnizim	6,395 t	12.2%
6 Udhëzimi Zyrtar	1 t	0%
7 Udhëtimi i punonjësve	117 t	0.2%
9 Transportimi dhe shpërndarja për shpërndarje	7,082 t	13.5%
Emetimi Total në Nivelin 3 të CO₂	52.626 t	100,0%
Emetimi Bruto Total në Nivelin 1 të CO ₂	318,740t	72.0%
Emetimi Total në Nivelin 2 të CO ₂	71,291t	16.1%
Emetimi Total në Nivelin 3 të CO ₂	52626,740t	11.9%
Total	442,657t	100,0%

DEKARBONIZIMI

Fokusi në prodhimin e produkteve më përmbajtje më të vogël të klinkerit dhe në përgatitjen e një lloji të ri të çimentos me përmbajtje më të vogël të klinkerit lidhet gjithashtu me përpjekjet e Sharrcemit për dekarbonizimin dhe optimizimin e portofolit të produkteve. Kjo qasje është testuar teknikisht me sukses dhe është e pranishme në treg që nga korriku i vitit 2021. Shkalla e plotë e ndikimit do të prezantohet me saktësi në vitin 2022.

Duhet të theksohet se për sa i përket performancës mjedisore, të gjitha emetimet mbahen nën nivelet e lejes së integruar.

FUSHA NË FOKUS: ZHVILLIMI – MUNDËSIA NË PUNË

Çështja materiale: Mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm në punë për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit përgjatë zinxhirit të vlerës

SHËNDETI DHE SIGURIA

Në vitin 2021, Sharrcepi shënoi një moment historik të rëndësishëm në lidhje me performancën e vet në fushën e shëndetit dhe sigurisë. Falë iniciativave të nisura nga Grupi i Çimentos TITAN, të cilat janë të përshtatura për kontekstin socio-ekonomik të Kosovës dhe kanë të bëjnë si me ngritjen e vetëdijes ashtu edhe me mirëqenien e anëtarëve të komunitetit, ne patëm disa arritje të rëndësishme. Ndër to duhet të theksojmë faktin se nuk kishim asnjë lëndim me kohë të humbur në punë (LTI) në vitin raportues, përfunduar me sukses kalimin nga standardi ISO 18001 në ISO45001, nisëm një sërë aktivitete për mirëqenie dhe 85% e punonjësve u vaksinuan me dozën e dytë.

Sa i përket masave për shëndetin dhe sigurinë, Sharrcepi vepron në përputhje të plotë me të gjitha ligjet dhe direktivat përkatëse vendore në fuqi dhe orientohet nga vizioni dhe politika e Grupit të Çimentos TITAN. Qëllimi i këtyre përpjekjeve të mëdha dhe të vazhdueshme është krijimi i një mjedisi të shëndetshëm për punë, pa incidente, lëndime dhe aksidente për të gjithë njerëzit që janë të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me punën tonë.

Sistemi i integruar i përgjegjësisë dhe llogaridhënies në fushën e shëndetit dhe sigurisë në Sharrcep mundëson ndarjen e njohurive me të gjithë. Garantimi që edhe palët e treta të miratojnë politika të ngjashme për shëndetin dhe sigurinë është një element thelbësor i punës së Sharrcepit.

Sharrcepi ishte një nga kompanitë e para kosovare që iu bashkua Këshillit Nacional për Shëndet dhe Siguri në Punë për të hartuar një plan veprimi për zbatimin dhe raportimin e politikave të shëndetit dhe sigurisë tek autoritetet shtetërore.

Përmbledhje e performancës në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë

- Këtë vit nuk ka pasur lëndime me kohë të humbur në punë (LTI).
- Shenja inkurajuese në treguesit e performancës në shëndet dhe siguri. Trendet tregojnë përmirësim të qëndrueshëm.
- Është arritur përparim i mirë në zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve të sigurisë.
- Janë kryer trajnimet e nevojshme, auditimet dhe inspektimet për sigurinë sipas planit vjetor., pavarësisht sfidave për të mbajtur programin e trajnimit për shkak të masave kundër COVID-19.
- Drejtori Rajonal për Shëndet dhe Siguri i Grupit të Çimentos TITAN ka kryer një auditim.
- Eurocert ka kryer një auditim për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë ISO45001 dhe e ka certifikuar Sharrcepin.
- Angazhimi i dëshmuar për të rritur standardet në tërë Njësinë Biznesore (BU).
- Regjistri i legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë vazhdon të monitorohet dhe rishikohet për të siguruar që uniti Biznesore të përmbushë detyrimet e veta statutore.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet stafit që nxitet përmes Këshillit të BL-së, BU-së, atij për Shëndet dhe Siguri.
- Kontrolli i rrezikut është arritur përmes veprimeve të koordinuara.
- Bashkëpunim i mirë me kontraktuesit.

- Të gjitha konstatimet nga kontrollet për Shëndetin dhe Sigurinë janë adresuar për t'u përmirësuar përmes urdhrave në punë ose regjistrave të veprimeve.
- Në vitin 2021 janë kryer kontrolle sistematike shëndetësore, në përputhje me kërkesat ligjore.
- Raportet i janë dorëzuar departamentit përkatës për veprime të mëtejshme të nevojshme.
- FUSHATA STIF është zhvilluar për të gjithë (është bërë një prezantim dhe fushata është ndjekur nga të gjithë punonjësit). Gjatë fushatës janë dhënë materialeve si postera, fletushka, shenja dhe ngjitës.


VEPRIMET KRYESORE

- Monitorimi i masave COVID-19 sipas protokolleve.
- Zhvillimi i proceseve të menaxhimit të sigurisë.
- Mbështetja e objektivave në nivel Grupi.
- Trajnimi dhe vetëdijesimi.
- Matja dhe monitorimi i performancës.
- Plotësimi i kërkesave ligjore dhe të tjera.
- Kontrolli operacional.
- Reagimi ndaj emergjencave.

Treguesit Kryesor të Performancës (KPI-të)


Ekziston struktura e KPI-ve. Departamenti për Shëndet dhe Siguri kryen monitorim të rregullt efektiv përmes 5 instrumenteve të treguesve kryesorë.

Lëndime me kohë të humbur në Punë (LTI)




1 Vdekje 2020/Kontraktues

Shkalla e Shpeshtësisë e Kohës së Humbur në Punë (LTIFR)




Ngjarje me Mundësi Lëndimi (Near Misses)



	2018	2019	2020	2021
Ngjarjet me mundësi lëndimi	10	13	14	36

Trajnime



	2018	2019	2020	2021
Orët me trajnime	6706	6574	3812	5235

Sfida e mbetur ka të bëjë me hetimin e incidenteve dhe ngjarjeve me mundësi lëndimi. Kjo fushë kërkon ende përmirësim në aspektin e cilësisë për njerëzit që janë të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me Sharrcemin. Nga gjithsej 36 hetime për incidente gjatë vitit 2021, 8 ngjarje me mundësi lëndimi janë kategorizuar si Lëndim i Mundshëm i Rëndë ose Vdekje (PSIF). Ne bëjmë përpjekje të vazhdueshme për t'i siguruar klientët dhe kontraktuesit se veprojmë sipas kërkesave të duhura në fushën e shëndetit dhe sigurisë.

COVID-19

Për Sharrcemin, shëndeti i të gjithë punonjësve dhe njerëzve të tjerë të lidhur me kompaninë është i rëndësishëm dhe është prioritet kryesor, gjatë gjithë kohës. Duke marrë parasysh sfidat shëndetësore që u paraqitën si pasojë e COVID-19, në vitin 2021 Sharrcemi bëri shumë përpjekje dhe investime në këtë drejtim duke marrë të gjitha masat e nevojshme. Masa të tilla përfshinin përmirësimin e kanaleve të hapura të komunikimit për punonjësit si një mënyrë për të përballuar efektet e distancës sociale, për të shkëmbyer informacione të dobishme me kohë për masat e higjienës personale etj. Sharrcemi ka krijuar gjithashtu një skemë të re pushimi me pagesë dhe mundësi për punë në distancë. Si rezultat, shumë punonjës kanë përfituar drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga këto veprime për të luftuar efektet e COVID-19.

Qëllimi i të gjitha masave të tilla të vendosura ishte mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve tanë të drejtpërdrejt dhe jo të drejtpërdrejt, dhe për të siguruar vazhdimësinë në punë.

Falë masave tona proaktive dhe veprimeve për ngritjen e vetëdijes, 85% e punonjësve tanë janë vaksinuar me dozën e dytë.

INICIATIVAT PËR MIRËQENIE

Trashëgimia e kujdesit e Grupit të Çimentos TITAN për punonjësit e tij vazhdon të evoluojë përmes angazhimit tonë për vitin 2025 për të kultivuar një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm dhe për të zbatuar iniciativat që adresojnë dimensionet fizike, mendore, sociale dhe financiare të mirëqenies për punonjësit në të gjitha vendet, duke përfshirë Sharrcemin në Kosovë.

Në vitin 2021, në Ditën Botërore të Shëndetit Mendor, Grupi i Çimentos TITAN lansoi një fushatë të Shëndetit Mendor, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e shëndetit të mirë mendor brenda Grupit. Duke adresuar nevojat lokale, Sharrcemi ka ofruar iniciativat dhe mundësi për punonjësit e vet për këtë qëllim.

Më poshtë është plani i veprimit me masat parandaluese:

- Komunikimet përkatëse me punonjësit dhe palët e interesit në lidhje me zbatimin e planit të veprimit parandalues.
- Koordinim me të gjithë kontraktuesit në terren, furnizuesit e rëndësishëm, klientët, në lidhje me të gjitha vendimet e qeverisë që kanë ndikim të mundshëm në punët tona direkte dhe indirekte.
- Zbatimi i orarit të ri të punës: puna nga shtëpia, pushim vjetor, puna me rotacion javor.
- Ndihma për komunitetin me materiale shpenzuese mjekësore në dispozicion, (sipas nevojës).
- Dhurimi i gjakut - 50 punonjës.
- Programi i asistencës së punonjësve në zhvillim e sipër.

'Programi i Asistencës për Punonjësit (EAP)' është një instrument unik që u shërben të gjithë punonjësve dhe familjeve të tyre, duke ofruar këshilla të ekspertëve për çështje personale, familjare ose të lidhura me punën, dhe për të ndihmuar në rritjen e mirëqenies shëndetësore, mendore dhe emocionale, dhe rritjen e performancës së punonjësve. Programi bën pjesë në trashëgiminë e grupit për kujdesin ndaj punonjësve.



Fizik

Mjeku i kompanisë
Kontrolle Mjekësore




Mendor

EAP
Mbarësi



Social

Darka pas dhurimit të gjakut
(Iftar-Ramazan)



Financiar

Sigurimi Shëndetësor
Sigurimi i Jetës
Ushqimi falas

Çështja materiale: Përfshirja dhe zhvillimi i punonjësve

PUNONJËSIT, PËRFSHIRJA DHE SISTEMI PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Punonjësit janë gjithmonë një prioritet gjatë vendimmarrjes sonë dhe kompania investon shumë në përmirësimin e kulturës së sigurisë, sigurimin e mirëqenies së tyre dhe zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Punonjësit tonë vazhdojnë të jenë burimi ynë më i vlerësuar. Respektimi i të drejtave të tyre të njeriut, ofrimi i kushteve të sigurta, të hapura, jodiskriminuese, të larmishme dhe të mira të punës dhe theksi në marrëdhëniet me punonjësit, mbeten prioritet për Sharrcemin në mënyrë që kompania të arrijë objektivat e veta. Politikatat e brendshme të punësimit dhe prokurimit në Sharrcem fokusohen kryesisht tek njerëzit dhe bizneset nga komuniteti lokal.

Angazhimi dhe bashkëpunimi me punonjësit tanë qëndron në qendër të strategjisë sonë. Komentet nga punonjësit tanë mbledhen në mënyrë të strukturuar dhe të organizuar, duke përdorur instrumente të tilla si anketat në të gjithë grupin, grupet e fokusit dhe anketat e pulsit lokal. Në vitin 2021, Grupi i Çimentos TITAN ka zbatuar Planet e Veprimit në nivel Grupi dhe Vendi që u krijuar për të adresuar rezultatet e Anketës së Përfshirjes së Punonjësve të mbajtur në vitin 2019.

Si rezultat, u prezantuan një sërë iniciativash, nga komunikimet më të shpeshta të punonjësve për prioritetet strategjike dhe fokusi në shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve në të gjithë TITAN-in, deri tek veprimet lokale, të tilla si thjeshtimi i proceseve të punës, programet e

fokusuara në zhvillim dhe përmirësimi i instrumenteve dhe proceseve të komunikimit lokal.

Ne besojmë se duke punuar ngushtë së bashku, ne krijojmë një kulturë pune bashkëpunuese dhe jo-diskriminuese. Ofrimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm për punë është zotimi ynë për t'u fokusuar në sigurinë e punonjësve tanë dhe për të promovuar mirëqenien e tyre fizike dhe mendore. Sharrcemi ka një kulturë të hapur dhe të larmishme për të përfshirë punonjësit e saj dhe për të promovuar përfshirjen dhe diversitetin. Kompania ofron shumë mundësi për zhvillimin e punonjësve të saj dhe i shpërblen ata rregullisht përmes kompensimit dhe përfitimeve konkurruese të bazuara në performancë.

Sharrcem është e përkushtuar të zbatojë Parimet e Kompaktit Global të OKB-së (www.unglobalcompact.org). Procedurat e BNj-së ofrojnë preferencë për punësimin e vendasve si përgjigje ndaj problemit të papunësisë në komunitet.

Komuniteti Vendor	2021	Përqindja
Po	160	68%
Jo	76	22%

Në vitin 2021, dy persona janë punësuar me kontrata pune me kohë të plotë (të dy janë vendas).

Punësime të Reja	2021	Përqindja
Femra	1	50%
Meshkuj	1	50%

Janë Larguar	2021	Përqindja
Femra	0	0%
Meshkuj	5	100%

Punësimi në Sharrcem deri në fund të vitit ka mbetur i qëndrueshëm. Dy persona të ri janë punësuar me kontrata pune me kohë të plotë (të dy janë vendas) dhe numri i grave të punësuar në fabrikë është rritur në 5.08%. 50% e të punësuarve të ri janë femra, gjë që përmbush objektivat tona të ESG-së dhe kontribuon në balancimin e profilit të punësimit në aspektin gjinor.

Punonjësit sipas gjinisë	2021	Fuqia Punëtore	2021	Anëtarët e Sindikatës	2021
Femra	12	Në Prodhim	165	Yes	82%
Meshkuj	224	Në Administratë	71	No	18%

Anëtarët e Bordit të Zgjeruar Menaxhues

16 Vendorë (lokal: 4)

4 Të huaj

Grupi i Çimentos TITAN ka financuar investimin e fundit në një sistem të menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMS), qëllimi i të cilit është përdorimi efektiv i të dhënave dhe menaxhimi i të gjitha proceseve kyçe përgjatë ciklit jetësor të punonjësve, nga ngritja e kapaciteteve deri te menaxhimi i performancës, mësimi dhe zhvillimi, planifikimi i karrierës dhe menaxhimi i shpërblimeve. Të dhënat nga HRMS në Grupin e Çimentos TITAN për rekrutimin, trajnimin (mësimin) dhe performancën analizohen për të ofruar informata të hollësishme dhe për të orientuar përpjekjet për përmirësim si dhe vendimet për investime në programet e ardhshme. Veç kësaj, të dhënat e performancës dhe planet individuale të zhvillimit përdoren në procesin e Rishikimit të Zhvillimit të Punonjësve si dhe në seancat për Telentët në Fushën përkatëse, dhe të dyja janë pjesë përbërëse e procesit të Planifikimit Strategjik të Fuqisë Punëtore të Grupit.

Për më tepër, Grupi i Çimentos TITAN ka përcaktuar Parimet e veta Globale për Modelet Hibride të Punës dhe ka përshkruar fushat kryesore për t'u përfshirë në nivel lokal. Bazuar në nevojat lokale, praktikën e tregut dhe pritshmëritë e punonjësve, Sharrcemi ka elaboruar dhe përdorur edhe më tutje praktikën lokale të punës në distancë.

KOSOVO GENERATION UNLIMITED

Projekti "Kosovo Generation Unlimited", i implementuar nga Rrjeti CSR në Kosovë dhe i mbështetur nga Programi i UNICEF-it në Kosovë si dhe nga SIDA, ishte shumë aktiv edhe gjatë këtij viti. Rrjeti ka arritur të akomodojë shumë vajza dhe djem të rinj në pozita praktike për të rritur përvojën profesionale të të rinjve në Kosovë. Në vitin 2021, Sharrcemi ka akomoduar gjashtë praktikantë përmes projektit "Kosovo Generation Unlimited". Ky projekt është aktualisht koalicioni më i madh shumë-sektorial në Kosovë që krijon një agjendë të përbashkët për të transformuar rezultatet kombëtare për të rinjtë në vend. Projekti Kosova Generation Unlimited vazhdon të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet praktikantëve dhe punëdhënësve në fusha të ndryshme. Nëpërmjet platformës, praktikantët dhe bizneset do të kenë mundësinë të krijojnë profilet e tyre dhe kjo është një formë e cila do të lehtësojë bashkëpunimin mes tyre. Stafi i Sharrcemit ka bërë shumë përpjekje për të ndarë aftësitë dhe njohuritë e tyre teknike me praktikantët që janë akomoduar në ambientet e Sharrcemit.

Çështja materiale: Vend i punës i larmishëm dhe gjithëpërfshirës

Duke qenë pjesë e Grupit të Çimentos TITAN, Sharrcemi është i përkushtuar të krijojë një mjedis ku të gjitha dallimet vlerësohen dhe ku të gjithë kanë mundësinë të përparojnë dhe të përjetojnë ndjenjën e përkatësisë.

Pas identifikimit të barazisë, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes si çështje materiale të TITAN-it për 2020-2025, u vendosën objektiva specifike për të rritur pjesëmarrjen e grave në kompani. Këto përfshijnë një angazhim për të promovuar mundësi të barabarta dhe gjithëpërfshirje, për të rritur me 20% pjesëmarrjen e grave në funksione të larta, në grupe të talentëve dhe punësime të reja, dhe për të arritur të paktën një të tretën e përfqësimit të grave në Bordin e Drejtorëve. Përqindja e grave në menaxhment mbetet e njëjtë, në 5.56%, si vitin e kaluar.

Gjatë vitit raportues, Sharrcemi ka punësuar punonjës të ri me kontrata pune me kohë të plotë, ku 50% ishin femra. **Në këtë mënyrë, Sharrcemi ka rritur numrin e punonjësve femra në 5.08% nga 4.60% sa ishte në vitin 2020.**



FUSHA NË FOKUS: NDIKIMI POZITIV NË MJEDISIN LOKAL

Çështja materiale: Performanca Mjedisore

MJEDISI

Çdo individ në kompaninë Sharrcem dhe në grupin e palëve të interesit, partnerëve të biznesit dhe komunitetit në afërsi janë plotësisht të vetëdijshëm për ndikimin që kanë operacionet e Sharrcem në natyrë dhe sa shumë ato operacione i përdorin burimet natyrore. Prandaj, kujdesi për mjedisin është një nga prioritetet kryesore të përgjegjësisë tona të përditshme në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe të punës. Në këtë drejtim, ne marrim parasysh se çfarë bëjmë dhe e bëjmë planifikimin e ndikimit të punëve tona sa i përket emetimeve në ajër, pluhurit dhe zhurmës, shëndetit dhe sigurisë, ndryshimit të peizazhit dhe përdorimit të lëndëve të para, energjisë dhe konsumit të ujit, dhe që të gjitha janë aspekte materiale për të tashmen dhe të ardhmen e njerëzve dhe të komuniteteve. Kjo është arsyeja pse secili prej nesh është plotësisht i përkushtuar për të kryer veprime që zvogëlojnë ndikimin tonë operacional në mjedisin natyror dhe përdorin BAT-in (Teknika më e Mirë në Dispozicion) dhe praktikën më të mira të qëndrueshmërisë për të siguruar që ne t'i adresojmë plotësisht këto çështje mjedisore përmes monitorimit, matjes, raportimit, bashkëpunimit të kujdesshëm dhe strategjik, veprim dhe përmirësim të vazhdueshëm të operacioneve tona.


Ne përdorim sisteme të menaxhimit për të monitoruar dhe raportuar ndikimin në mjedis, duke i caktuar Sharrcemit objektiva për reduktimin e emetimeve në ajër, mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, si dhe rehabilitimin e guroreve. Ne shkojmë edhe përtej zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve mjedisore lokale në fuqi dhe zbatojmë standardet e Grupit TITAN që plotësojnë standardet specifike globale dhe të industrisë. Ne investojmë për të rritur ndërgjegjësimin e palëve kryesore të interesit, duke përfshirë punonjësit tanë, komunitetet tona, klientët dhe furnizuesit tanë për të adresuar çështjet materiale, për të vendosur objektiva afatgjata dhe për të përmbushur objektivat tona strategjike. Ne çdo vit i kontrollojmë rezultatet e menaxhimit të performancës sonë përmes auditimeve të brendshme dhe të jashtme të pavarura. Sharrcem kujdeset dhe investon në edukimin e komunitetit se si të ruajë një mjedis të pastër, të sigurt dhe të qëndrueshëm. Për të mbështetur përpjekje të tilla, në vitin 2021 janë kryer dy auditime të sistemeve tona të menaxhimit: një auditim i brendshëm nga Departamenti për ESG në Grupin e Çimentos TITAN dhe një auditim i jashtëm.

EMETIMET NË AJËR


Përtej kërkesave legislative, kompania ka vendosur vullnetarisht të krijojë dhe të përdor një Sistem për Monitorim të Vazhdueshëm të Emetimeve (CEMS) që nga fillimi i vitit 2013. Sharrcemi vepron sipas teknikës më të mirë në dispozicion (BAT), në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale 2010/75/EU dhe Lejen IPPC.

Emetimet e SO_x janë shumë të ulëta për shkak të përqendrimit të tyre të ulët në lëndët djegëse dhe në lëndën e parë. Emetimet e SO_x janë nën kufijtë (EV) e përcaktuar nga rregulloret lokale dhe ato të BE-së që janë në fuqi. Për më tepër, emetimet e SO_x janë zvogëluar edhe më shumë.

Emetimet e SOx [mg/Nm³]




Emetimet e NOx [mg/Nm³]




Në vitin 2021, emetimet e përgjithshme të NOx nga Sharrceci ishin nën kufijtë (ELV) e përcaktuar në lejen IPPC dhe ka përmirësim në performancë krahasuar me vitet e kaluara.

Emetimet e pluhurit nga burimet kryesore të fabrikës mbeten shumë e ulëta në krahasim me kufijtë e përcaktuar në IPPC. Për më tepër, emetimet e pluhurit janë zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar.


Emetimet e Pluhurit - Furrë [mg/Nm³]



Emetimet e Pluhurit – Ftohësi i Klinkerit [mg/Nm³]



Emetimet e Pluhurit CEM2 [mg/Nm³]



AGJENCIA JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (JICA)

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në Kosovës, gjatë zbatimit të fazës së dytë të projektit “Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës”, i cili është mbështetur nga JICA, është dashur të organizojë një vizitë studimore në një kompani në Kosovë që ka një sistem për monitorimin e emetimeve në ajër dhe që zbaton standardet mjedisore. MMPHI ka përzgjedhur Sharrcemin për ta vizituar.

Rrjedhimisht, një ekip i ekspertëve nga Japonia i janë bashkuar përfaqësuesve të ministrisë në një vizitë në fabrikën tonë e cila është identifikuar si një kompani e cila është shembull dhe është kompania e parë në vend që ka marrë lejen e parë IPPC.


REHABILITIMI I GUROREVE DHE BIODIVERSITETI

Pas vendimit për zgjerimin e sipërfaqes së zbrazët në pjesën lindore të gurores për të shfrytëzuar eksploatimin në mënyrë sa më racionale, plani progresiv i rehabilitimit të gurores së mergelës në Dimcë (plani 5-vjeçar i rehabilitimit) do të vazhdojë vitin e ardhshëm.

Përqindja aktuale (%) e guroreve të rehabilituara është rreth 23%.

Deri më tani janë mbjellë më shumë se 1200 fidane të reja që nga fillimi i programit të rehabilitimit të guroreve në vitin 2014 (në mënyrë kumulative).

Gurorja e gurit gëlqeror në Seqishtë funksionon për nevojat e fabrikës Sharrcem, e cila është në fazën fillestare të eksploatimit dhe ka Leje Mjedisore të lëshuar nga MMPHI në dhjetor të vitit 2018 për një periudhë 5 vjeçare. Rehabilitimi teknik i sipërfaqeve të zbrazëta do të bëhet pas zgjerimit të tyre në zonat për të cilat do të përdoret një leje e re për eksploatim gjatë vitit 2022.



Çështja materiale: Angazhimi dhe Kontributi për Komunitetet tona Lokale

VLERËSIMI I INICIATIVAT DHE VEPRIMET PËR ANGAZHIMIN E KOMUNITETIT NË VITIN 2021

Përmbledhje e pikave kryesore për vlerësimin e vitit 2021

- 15 iniciativa dhe veprime në fushën e ESG-së janë vlerësuar në fund të vitit 2021 në koordinim mes Sharrcemit dhe Grupit të TITANIT. (Shënim: 90% e të gjitha iniciativave janë zbatuar për Angazhimin e Komunitetit)

- Iniciativat e vlerësuara që lidhen me Çështjet Materiale në kuadër të Kapitalit të SASB-së:

Kapitali Social 56% e rasteve të lidhura

Udhëheqje Qeverisje 19% e rasteve të lidhura

Kapitali Njerëzor 15% e rasteve të lidhura

I pasuar nga:

Modeli i Biznesit dhe Inovacioni 7% e rasteve

Mjedisi 4% e rasteve

- Iniciativat për Angazhimin e Komunitetit kryesisht kanë të bëjnë me 5 prioritetet kryesore të komuniteteve:



Edukimi i njerëzve në komunitete (shkolla)

MBËSHTETUR NGA 9 INICIATIVA



Të tjera (mbështetje për komunitetet lidhur me shqetësimet),

MBËSHTETUR NGA 5 INICIATIVA

I pasuar nga:



Aftësi për punë të reja (trajtime, praktika etj.)

MBËSHTETUR NGA 8 INICIATIVA



Infrastruktura për komunitetet, rritja e punësimit dhe krijimi i vendeve të punës

3 INICIATIVA NË SECILËN FUSHË

- Niveli i lartë i angazhimit të komunitetit: Nivelet “Përfshirja” dhe “Bashkëpunimi” arriten në 100%, dhe “Fuqizimi” arriti në 53% të përqindjes së të gjitha iniciativave.
- Kanë qenë më shumë se 180 pjesëmarrës në total, nga të cilët rreth 90 kanë qenë punonjës të TITANIT si vullnetarë.
- Kanë qenë rreth 4,830 përfitues në total.
- Kostoja totale është rreth 129,000 Euro.

Në të vërtetë, analiza ka konstatuar se sa i përket nivelit të angazhimit të Sharrcemit me komunitetin, më shumë se 80% e iniciativave arritën me sukses përfshirjen aktive të palëve të interesit, derisa gati 20% promovuan bashkëpunimin e mirë me anëtarët e komunitetit.

Duke qenë të frymëzuar nga rezultate të tilla dhe të orientuar nga vlerat globale të grupit, Sharrcemi është fokusuar për të vazhduar në forcimin e angazhimit të mirëfilltë shoqëror si një mënyrë për të rritur ndikimin tonë pozitiv shoqëror.

Sharrcemi ia doli gjithashtu të jepte një shembull pozitiv për përfituesit duke u përfshirë në mënyrë aktive në iniciativat që përmirësojnë infrastrukturën e komunitetit lokal në shkollat dhe spitalet publike, si dhe qendrat rekreative për aktivitetet rinore.

Në vitin 2021, iniciativat dhe veprimet e Sharrcemit u përfshinë në një vlerësim të strukturuar të kryer nga sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit (të dhënat për ESG) të Grupit të Çimentos TITAN. Qëllimi i këtij ushtrimi ishte të sigurohet përafrimi i Sharrcemit me çështjet materiale të grupit.

LAB - Laboratori për Aktivitete të Biznesit

Bashkëpunimi me autoritetet komunale dhe institucionet lokale mbetet temë kyçe në agjendën e Sharrcemit. Projekti LAB i cili filloi në vitin 2014 për të ndikuar pozitivisht në situatën socio-ekonomike në Komunën e Hanit të Elezit në thelb synon krijimin e ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme, të cilat mund të ndihmojnë në uljen e papunësisë dhe varfërisë. Në vitin 2021, Sharrcemi ka mbështetur edhe një grup të ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme, kryesisht në prodhimin bujqësor, dhe ato janë mbështetur nga fondi i krijuar nga LAB. LAB ka vazhduar mbështetjen e suksesshme për sektorët e viteve të mëparshme dhe ka zhvilluar sektorë të rinj duke zbatuar qëllimet strategjike të projektit LAB si dhe strategjinë e Grupit Titan për CSR. Rezultatet e deritanishme: 139 biznese të reja janë krijuar në sektorin e bujqësisë dhe pemëtarisë (sera, pemë të imëta, bletari, kërpudha, blegtori, vreshta, pylltaria - shfrytëzim i biomasës së drurit për energji, shpeztari, etj.).

Edhe gratë kanë përfituar nga programi LAB. Për të gjithë përfituesit në kuadër të sektorit përkatës, u organizuan

trajnime përkatëse teorike dhe praktike për përgatitjen e tyre për t'u angazhuar në mënyrë më efektive në zbatimin e objektivave të projektit.

Veç kësaj, janë ofruar lloje të ndryshme të trajnimeve tematike profesionale si dhe trajnime të ngjashme praktike në terren për të përmirësuar njohuritë për bujqësi dhe blegtori intensive sipas standardeve.

Duke qenë se qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme me qëllim të uljes së papunësisë dhe varfërisë, ne besojmë se përmes projektit LAB, Sharrcemi ka adresuar disa nga çështjet më të rëndësishme që prekin komunitetin tonë. Në përputhje me vlerat e CSR-së, Sharrcemi ka premtuar se do të jetë gjithmonë pranë komunitetit duke ofruar mundësi të ndryshme për të pasur ndikim pozitiv. I tillë është projekti LAB, objektivi i të cilit është të sigurojë vende pune për personat e papunësuar në komunitet.



BORDI KËSHILLUES LOKAL I PAVARUR (ILAB/BOPAL)

Edhe ky është një program më shumë dobi për komunitetin lokal. Sharrcepi ka themeluar Bordin Këshillues Lokal të Pavarur (ILAB) në vitin 2011, i cili është një organ i përbërë nga palët e interesit nga komuniteti lokal si komuna, OJQ-të dhe qytetarët dhe është krijuar për të investuar në mënyrë të pavarur fondin e Sharrcepi aty ku janë nevojat më të mëdha për të zhvilluar komunitetin.

Në vitin 2021, Sharrcepi ka vazhduar të kontribuojë për komunitetin lokal edhe përmes Bordit Këshillues Lokal të Pavarur (ILAB/BOPAL). Sharrcepi ka mbajtur disa takime me Bordin Këshillues Lokal të Pavarur dhe gjatë këtyre takimeve janë zbatuar propozime të ndryshme. Këtë vit është mbështetur komuniteti si dhe aktivitetet kulturore dhe sportive. ILAB ka vazhduar të shërbejë si një instrument i shkëlqyer i komunikimit për të përmirësuar nevojat e komunitetit lokal.

Shpjegimi i kontributit nga ILAB/BOPAL në vitin 2021

Mbështetja për komunitetin: 3000 Euro
Përfituan 10 persona/familje

Aktivitete Kulturore dhe Sportive: 12000 Euro
Përfituan 4 klube/shoqata

FUSHATA E DHURIMIT TË GJAKUT

Sharrcepi organizon çdo vit fushatën e dhurimit të gjakut si një mjet për të theksuar rëndësinë e kontributit në shpëtimin e jetëve përmes këtij aktiviteti, duke motivuar dhuruesit e rregullt të gjakut që të vazhdojnë të japin gjak dhe duke inkurajuar njerëzit me shëndet të mirë, veçanërisht të rinjtë, të cilët kurrë nuk kanë dhuruar gjak, që të fillojnë ta bëjnë një gjë të tillë.

